

# PROGRAMI ZGJEDHOR 2025-2029





# Fjala e Kandidatit për Kryeministër Ramush Haradinaj



Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Të nderuar anëtarë dhe simpatizantë të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës; të partnerëve të koalicionit, Nisma Socialdemokrate, Lista Konservatore dhe Forumi E30,

Të nderuar bashkatdhetarë;

Ky program është rezultat i një pune dyvjeçare. Rezultat i mbi 20 tryezave tematike e sektoriale, dhjetëra takimeve dhe konsultimeve të organizuara nga Aleanca dhe partnerët, ku kanë marrë pjesë qindra ekspertë të profileve e fushave të ndryshme: të ekonomisë e financave, arsimit e shëndetësisë, çështjeve sociale e kategorive të lirisë, sigurisë, politikës së jashtme e diplomacisë,

energjisë, kulturës, ambientit, rinisë.

Programi shpalos orientimin tonë për një Kosovë ndryshe.

Për një Kosovë, për të cilën është punuar ndër breza dhe janë burgosur e kanë dhënë jetën mijëra luftëtarë e patriotë.

Vizioni ynë i shprehur në këtë Program për një Kosovë më të plotë, më sovrane, më të fortë, më demokratike e më të zhvilluar, qëndron mbi 4 shtylla:

- Anëtarësimi direkt i Kosovës në NATO;
- Zhvillimi i hovshëm ekonomik;
- Përmbyllja e Dialogut me Serbinë me njohje reciproke dhe integrim në BE;
- Kosova shtet i jetueshëm e jo i braktisur.

## **Anëtarësimi direkt i Kosovës në NATO**

Plani dhjetëvjeçar i dakorduar me Amerikën dhe NATO-n është themeli për veprimin e ardhshëm - anëtarësimin direkt. Partneriteti për Paqe tashmë është realizuar përmes këtij plani. Tani, Kosova synon anëtarësimin e plotë në NATO përmes një plani të ri që përfshin tri aspekte kryesore:

### **1. Politik:**

- Forcimi i marrëdhënieve me institucionet euroatlantike
- Përmbushja e obligimeve në dialog
- Konsolidimi i demokracisë në Kosovë
- Përmirësimi i marrëdhënieve me fqinjët

### **2. Ushtarak:**

- Ngritja e kapaciteteve luftarake të Ushtrisë së Kosovës
- Zhvillimi i industrisë mbrojtëse
- Prodhimi i municioneve dhe pajisjeve të tjera ushtarake
- Përmirësimi i infrastrukturës ushtarake dhe mbrojtëse civile

- Rritja e kontributit të Kosovës në angazhimet e NATO-s

### 3. Ekonomik:

- Aktivizimi i resurseve të Kosovës për partneritet ekonomik me vendet e Aleancës

Anëtarësimi në NATO do të sjellë përfitime të shumta:

- Do të jetë kthesa më e madhe e sigurisë për Kosovën;
- Do të garantojë zhvillim ekonomik duke rritur vlerën e resurseve dhe potencialeve të vendit;
- Do të inkurajojë investitorët e vendit dhe të huaj;
- Do ta shndërrojë Kosovën në një adresë të rëndësishme ekonomike.

Kjo kthesë e madhe ekonomike do të sigurojë:

- Qëndrimin e qytetarëve, veçanërisht të rinjve, në Kosovë;
- Përmirësimin e sistemit shëndetësor, duke ofruar shërbime cilësore për të gjithë;
- Ngritjen e cilësisë së arsimit në nivelin e vendeve të NATO-s;
- Përshtatjen e arsimit me nevojat e tregut të punës;

Aleanca hyn në zgjedhje me vizionin e kësaj kthese të madhe në siguri dhe ekonomi. Ky vizion synon të sigurojë:

- Paga dhe pensione të dinjitetshme për qytetarët;
- Kushte më të mira jetese;
- Zhvillim të qëndrueshëm në të gjitha sferat.

Udhëheqja nacionale kërkon vizion të gjerë. Anëtarësimi në NATO është përgjigja për zhvillimin e përgjithshëm të vendit, duke përfshirë qëndrimin e popullatës, përmirësimin e arsimit dhe shëndetësisë, si dhe sigurimin e pagave të dinjitetshme.

### **Zhvillimi Ekonomik**

Zhvillimi i hovshëm ekonomik nënkupton:

- Rritja minimum 7% e GDP-së në vit. Kjo realizohet duke rritur investimet publike në 1 miliard e 100 milionë në vitin 2025, për të arritur në 1.5 miliard për vit në vitin e fundit të mandatit.

- Investimet e huaja direkte, në lartësinë deri në 2 miliardë që bashkë me investimet e sektorit privat do të arrinin në 5 miliardë për vit.
- Lehtësirat në politikën fiskale për investime.
- Kjo siguron edhe një situatë ku Kosova do të përfitonte shuma të mëdha nga projektet rajonale të financuara nga BE, por edhe donacione nga fonde ndërkombëtare siç janë Banka Botërore, FMN, BERZH etj.
- Zhvillim ekonomik do të thotë që të mos vidhet në emër të luftës kundër korrupsionit:
  - o Ku biznesi privat apo sindikatat nuk do të trajtohen si armiq por si partnerë;
  - o Ku nuk do të ketë pagë nën 500 euro;
  - o Ku paga mesatare do të jetë jo më pak se një mijë euro;
  - o Ku nuk do të ketë familje të përjashtuara nga skema sociale;
  - o Ku qeveria nuk do t'i bllokojë paratë në “bunker”, duke mos rritur pagat e duke bllokuar investimet kapitale.

## **Përmbyllja e dialogut me Serbinë me njohje reciproke dhe integrim në BE**

Kosova duhet t'i shemb themelet e autonomisë për komunitet me shumicë serbe që me veprimet apo mosveprimet e veta, i ka vendosur pushteti i sotëm.

Kosova do ta përmbyllë dialogun dhe t'i rikthehet marrëveshjes gjithëpërfshirëse dhe obligative me njohje reciproke.

Një marrëveshje përfundimtare me njohje reciproke do të vendoste paqe të përhershme në këtë pjesë të Evropës.

Kosova do t'i përmbushë të gjitha obligimet e saj në bashkëpunim me aleatët, posaçërisht SHBA.

Aleatët kurrë nuk e kanë tradhëtuar Kosovën. Integrimet Euroatlantike janë jo vetëm aspiratë e jona, po janë gjithçka për Kosovën dhe rrugë e vetme drejt prosperitetit dhe paqes së përhershme.

Anëtarësimi në të gjitha strukturat euroatlantike është jo vetëm e drejtë, por edhe obligim i këtij brezi. Ne duhet t'i kryejmë detyrat e shtëpisë dhe në këtë mandat gjithçka do të jetë e fokusuar në implementimin e obligimeve që ka Kosova ndaj procesit integruar.

## **Kosova shtet i jetueshëm e jo i braktisur**


Siguria ekonomike dhe sociale janë dy ndër parakushtet kryesore që vendi të bëhet i jetueshëm. Që Kosova të bëhet vend i jetueshëm e jo gjithnjë e më shumë i braktisur, duhet që pushteti të punojë për popullin e jo për vete. Kjo nënkupton që taksat e qytetarëve të mos u jepen "jaranave e dostave" të qeverisë, me qindra milionë euro në tendera njëburimor, por të investohen në mirëqenien e tyre.

Për të arritur këtë qëllim, është thelbësore të mbështetet biznesi e të krijohen mundësi për hapjen e vendeve të reja të punës. Njëkohësisht, duhet të sigurohemi që shërimi të mos jetë më i shtrenjtë se shëndeti, duke përmirësuar sistemin shëndetësor. Arsimi duhet të ngrihet në nivel të konkurrueshëm me vendet perëndimore, duke e larguar nga fundi i listës ku ndodhet aktualisht.

Një aspekt tjetër kritik është krijimi i kushteve që të rinjtë të shohin të ardhme në këtë vend, e jo mundësinë e parë për ta braktisur atë. Të gjitha këto synime mund të realizohen duke pasur

një vizion të qartë e një program gjithëpërfshirës, që e synon atë Kosovën ndryshe, më të plotë, më sovranë, më të fortë, më demokratike e më të zhvilluar dhe të integruar direkt në Nato. Vetëm duke ndjekur këtë rrugë, Kosova mund të transformohet nga një vend i braktisur në një shtet vërtet të jetueshëm për të gjithë qytetarët e saj.

Na priftë e mbara!





# PRIORITETET PROGRAMORE

Direkt në NATO- Plani i veprimit për anëtarësim	Konsolidimi demokratik dhe institucional	Ndërtimi i imazhit dhe profilit shtetëror
Zhvillimi ekonomik	<b>Solidariteti dhe përkrahja sociale</b>	<b>Familja</b>

## *DIREKT NË NATO*



# DIREKT NË NATO

**Konteksti, Sfidat, Mundësitë** - Integrimi direkt i Kosovës në NATO dhe Bashkimin Evropian (BE) është një objektiv kyç për stabilitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Është paradoksale dhe anakronike të mendohet që ky proces mund ta ketë ritmin dhe rrjedhën e natyrshme dhe progresive, për aq kohë sa nuk manifestohet me bashkëpunim dhe partneritet konsistent, me prezencën e fuqishme të këtyre dy organizatave ndërkombëtare në Kosovë. Në tri vitet e fundit, lidërshipi institucional i vendit është kritikuar për një mori çështjesh nga këto organizata dhe vende anëtare të tyre. Kosovën kjo nuk e shpie askund. Kritikat përfshijnë qasje jo konstruktive në dialog, ngritje të tensioneve, cenim të administratës publike, qasje destruktive ndaj opozitës, centralizim të pushtetit dhe qasje agresive kundër gjuqësorit dhe mediave të lira.

Porosia jonë është që kjo prezencë, e kombinuar me perspektivën e premtuar për shtetet e Ballkanit Perëndimor për anëtarësim, për Kosovën është një përparësi shtesë. NATO dhe BE, përtej mandatit të tyre të përditshëm në Kosovë, janë edhe platforma dhe mundësi ancorimi që Kosova të bëhet pjesë e tyre. Prezenca e tyre ofron mundësi për përmirësimin e sigurisë dhe ekonomisë dhe për t'i dhënë Kosovës një rol të qëndrueshëm në familjen evropiane dhe transatlantike.

Koalicioni AAK - NISMA- Konservatorët - E30, është i angazhuar për anëtarësim direkt në NATO dhe integrim sa më të shpejtë në BE, me përkushtim dhe qasje strategjike. Nëpërmjet këtij programi, ne synojmë t'u bëjmë ballë sfidave të sigurisë nëpërmjet rritjes së vazhdueshme të kapaciteteve të mbrojtjes, njëkohësisht anëtarësimit dirket e të plotë në NATO. Gjithashtu, synojmë rikthimin në krye të agjendës të reformave për procesin e integritimit evropian.

Anëtarësimi i Kosovës në BE dhe NATO është proces kompleks dhe sfidues. Përplasja dhe konfrontimi diplomatik brenda

Kosovës, në Bruksel e Uashington, është injorancë dhe paaftësi në lidhje. Në rrafshin e brendshëm, ky proces kërkon angazhim konsistent të shoqëruar me rezultate të matshme, të cilat shkojnë përtej arritjeve në sektor veç e veç apo administratë publike dhe institucione. Anëtarësimi kërkon edhe një përkushtim dhe reformë socio-ekonomike.

Në rrafshin e ndërkombëtar, ky proces kërkon arritje dhe suksese në forcimin e marrëdhënieve bilaterale dhe multilaterale. Kushdo që mendon që rrugëtimi drejt NATO-s dhe BE-së mund të realizohet përmes një qasjeje diplomatike konfrontuese me vendet lidere, por edhe me vende të tjera anëtare të tyre, ose udhëhiqet nga një agjendë e dyshimtë, ose nuk ka njohuri elementare mbi funksionimin e këtyre organizatave, objektivat dhe përkushtimin e tyre afatgjatë.

Sidoqoftë, duhet nënvizuar dy momente të rëndësishme në këtë drejtim. Në lidhje me rrugëtimin, apo përmbushjen e kriterëve në proces, funksionimi i këtyre organizatave multilaterale nuk kërkon gjithmonë një qasje konsensuale të vendeve anëtare. Përderisa akti formal i pranimit kërkon një konsensus të vendeve anëtare, institucionet e Kosovës duhet të arrijnë ta përshtatin agjendën e integritimit në varësi nga konteksti dhe rrethanat, gjithnjë duke zhvilluar një komunikim teknik dhe strategjik me palët relevante.

Si në lidhje me rrugëtimin ashtu edhe me vetë aktin e pranimit në vitet që vijnë, një nga sfidat më të mprehta të Kosovës në këtë rrugëtim është pozicioni i vendeve hezituese, kryesisht atyre mosnjohëse. Së fundi kemi parë që, në mungesë të zhdërvjelltësisë në interpretimin e kësaj agjende nga institucionet e Kosovës, ka pasur edhe vende njohëse që kanë filluar të shfaqin hezitim. Një përafrim me vendet njohëse të Bashkimit Evropian (Spanjë, Greqi, Qipro, Rumania dhe Sllovakia), i shoqëruar me vendosje dhe afirmim të marrëdhënieve bilaterale me to, do të ishte i një rëndësie strategjike

për forcimin e kapacitetit të Kosovës në këtë drejtim. Kjo sfidë ka kohë që njihet nga të gjithë akterët politikë dhe institucionalë në vend, por njëkohësisht pothuajse nuk ka ndodhur asnjë arritje strategjike për adresimin e saj.

Një sfidë tjetër me kalimin e viteve është bërë jo dialogu dhe normalizimi i shumëpritur dhe shumëkërkuar i marrëdhënieve me Serbinë, por stërzgjatja dhe obstrukcionet që Serbia i ka bërë këtij procesi në funksion të ruajtjes së statusquo-së së marrëdhënieve të tensionuara. Kjo ka bërë që të humbet shumë energji me efekte negative për Kosovën në këtë proces. Kjo është pikërisht e kundërta e pritjeve dhe e agjendës së Perëndimit, dhe është një tregues i qartë që Serbia po provon ta mirëmbajë agjendën e partnerëve joperëndimorë në lidhje me dialogun. Kosova duhet që me veprime të qëndrueshme të tregojë që ka durimin dhe zhdërvjelltësinë që, edhe duke qenë pjesë aktive e dialogimit, ndryshe nga Serbia, të demonstrojë që agjenda e saj është e harmonizuar me SHBA dhe BE.

Në natyrën e funksionimit dhe në vetë parimet mbi të cilat është ndërtuar BE, dialogu konceptohet si e vetmja platformë e tejkalimit të sfidave. NATO, si organizatë e sigurisë kolektive, për sa i takon Ballkanit Perëndimor, është aktori kryesor i cili afirmon fuqishëm pozicionet politike dhe institucionale të BE. Përderisa Serbia ka një qasje anakronike përkitazi me këto dy organizata dhe përgjithësisht mirëmban një marrëdhënie "tërhiq e mos këput" me to, duke gravituuar në thellimin e bashkëpunimit me Federatën Ruse dhe me Kinën, Kosova historikisht është fuqishëm e orientuar t'i takojë dhe të bëhet pjesë e komunitetit demokratik perëndimor. Pra, qasja e Kosovës në procesin e dialogimit duhet të jetë diametralisht e kundërt nga ajo e Serbisë. Synimet e Kosovës në këtë proces janë afatgjata dhe strategjike, përderisa ato të Serbisë janë oportuniste.

Kokëfortësia e Serbisë për të provuar ta kufizojë afirmimin ndërkombëtar të Kosovës, me tendencë mbajtjen e shtetësisë së Kosovës në një pozicion të limituar në nivel global, duhet t'i kushtojë para së gjithash Serbisë me qasje të kufizuar në procesin e

negocimit të statusit të saj me BE dhe me partneritetin e saj me NATO, SHBA dhe vende të tjera lidere në BE. Paaftësia aktuale e lidershimit të Kosovës është duke bërë pikërisht të kundërtën.

Përderisa Kosova në raport me BE dhe SHBA si ndërmjetës e ka më komplekse ta definojë se ku po fillon dhe ku po përfundon roli i tyre si ndërmjetës duke u kthyer në palë, njëkohësisht ky është edhe një avantazh i madh në raport me Serbinë, e cila hapur dhe heshtur afirmon një pozicion që qasja e saj karshi këtyre dy organizatave është egoiste dhe refuzuese. Duke ditur që BE dhe NATO në procesin e anëtarësimit nuk "importojnë" çështje të hapura të sigurisë, Kosova duhet të ketë një qasje kreative me të cilën në procesin e dialogimit dëshmon që i vetmi aktor i cili mirëmban dhe prodhon probleme të sigurisë, siç ka qenë gjithmonë, vazhdon të mbetet Serbia.

Sfidë tjetër është sundimi i ligjit dhe konsolidimi i qeverisjes demokratike. Si një nga problemet dhe sfidat më të mprehta përtej nevojës për zhvillim socio-ekonomik, në lidhje me anëtarësimin në BE, por së fundi edhe në lidhje me procese ku NATO ka shtuar interesin, është edhe kërkesa që vendeve kandidatë u bëhet për efikasitet në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar. Përgjatë viteve, Kosova ka treguar një ngritje graduale të performancës dhe rezultateve në këtë drejtim. Sidoqoftë, niveli i lartë i korrupsionit dhe krimin të organizuar vazhdon të mbetet kryefjala në vlerësimet dhe raportimet e organizatave ndërkombëtare. Në këtë drejtim nuk mjaftojnë sukseset e pjesshme dhe rezultatet sporadike.

Kosova duhet të ndajë mjetet e nevojshme financiare në nivel vendi, duhet të investojë në ndërtimin e kapaciteteve të reja që lidhen me ekspertizë dhe fuqizimin e atyre aktuale, duhet të krijojë një kuadër ligjor i cili priorizon luftimin e këtyre dukurive, dhe njëkohësisht duhet të ndërtojë një kornizë të vlerësimit të arritjeve dhe identifikimit të sfidave. Kjo nuk është një ndërmarrje pronësia e së cilës mund të ketë disa hisedarë, sepse është e qartë që luftimi i korrupsionit dhe krimin të organizuar kërkon një ndërgjegjësim dhe përkushtim të fuqishëm institucional, e pse jo edhe mbarëkombëtar.

Një sfidë apo çështje e cila kërkon vëmendje të shtuar politike dhe institucionale është përafrimi me standardet e BE dhe ato të NATO. Përgjatë viteve kemi parë intensivisht që në kuptimin e aprovimit, Kosova ka pasur një qasje proaktive në përqafimin dhe afirmimin e standardeve në fjalë. Kjo është realizuar edhe për faktin që deri më tani një kontigjent i rëndësishëm i të rinjve kanë përfunduar studimet dhe janë specializuar në çështje të procesit të integritit të BE, ku një numër i tyre ofron kontributin në disa institucione në rrafshin qendror apo atë lokal.

Ajo çfarë ka munguar në këtë rrugëtim është fakti që shpesh aprovimi i këtyre normave dhe standardeve nuk është paraprirë nga një vlerësim i gjendjes, në mënyrë që Kosova organikohej të jetë në nivelin e pritur të performancës. Është e ditur që BE nuk i imponon vendeve të aplikojnë standarde për të cilat nuk kanë kapacitetet e kërkuara. Përkundrazi, kur është e nevojshme, në funksion të përmbushjes së tyre, ofron mekanizma mbështetës në këtë drejtim. Njëkohësisht mund të thuhet që standardet në fuqi nuk janë shoqëruar gjithnjë edhe me vlerësimin e impaktit, e si rrjedhojë ka munguar totalisht një qasje komunikuese e cila afirmon rëndësinë e transformimit në proces të integritit evropian dhe e cila minimizon efektet e padëshiruara socio-ekonomike në këtë drejtim.

Nevojitet që të ndërtohen praktika dhe mekanizma të vlerësimit paraprak të gjendjes, planifikimit të asistencës institucionale dhe përmes ekspertizës, vlerësimit të impaktit, komunikimit institucional dhe atij publik, dhe në fund fare, adresimit proaktiv të sfidave në këtë proces. Kjo qasje, përpos që i përgjigjet shqetësimeve eventuale në procesin e integritit, njëkohësisht në disa vite gjeneron një potencial të fuqishëm për përshpejtimin e hapave të integritit, si dhe i shërben proceseve të pas anëtarësimit. Në lidhje me anëtarësimin në NATO, sfidat e fundit të sigurisë në nivel evropian dhe global, kanë shtruar nevojën që Kosova të forcojë kapacitetet e planifikimit afatmesëm dhe që ato të ndërtohen mbi një komunikim të ngushtë politik dhe diplomatik me vendet lidere sikurse

SHBA-të dhe Mbretëria e Bashkuar.

Prandaj, koalicioni AAK - NISMA - Konservatorët - E30 e konsideron anëtarësimin e Kosovës në NATO dhe Bashkimin Evropian si një përparësi strategjike dhe një hap thelbësor drejt forcimit të sigurisë kombëtare dhe stabilitetit ekonomik. Për të arritur këto qëllime, ne kemi hartuar një strategji gjithpërfshirëse që përfshin bashkëpunim të ngushtë me partnerët tanë ndërkombëtarë, zhvillimin e kapaciteteve të mbrojtjes dhe përmbushjen e kriterëve të nevojshme për integrim në institucionet euro-atlantike.

**Masat dhe Veprimet** – Fokusi ynë është thellimi i partneritetit dhe qëndrueshmëria e procesit të përparimit drejt anëtarësimit direkt në NATO. Kjo është e mundur vetëm përmes një qasjeje metodike, të strukturuar dhe strategjike, e cila mbështetet në një koncept të përafrimit, komunikimit dhe koordinimit permanent. E gjitha duke buruar nga koncepti dhe parimet që me NATO-n prezente në Kosovë, anëtarësimi i Kosovës në NATO është një proces i pashmangshëm. Asnjë sfidë e natyrës politike, si rezultat i propagandës kundër shtetit të Kosovës nga Serbia, nuk duhet e as nuk guxon të gjejë shtrirje dhe as të bëhet shkaktar a burim i ndonjë stagnimi në këtë proces.

NATO dhe KFOR-i nuk janë vetëm palë në raport me Kosovën, sikurse është rasti me Serbinë, e cila nuk sheh të ardhme në këtë organizatë. Përkundrazi, NATO dhe KFOR-i janë pjesë e Kosovës dhe historisë së saj. Ky është një realitet i cili nuk do të ndryshojë, pavarësisht ndryshimeve kontekstuale apo ndryshimeve në qeverisje në Kosovë.

### **Politike:**

- Kosova do të kërkojë të përfshihet në "Dialog të Dizajnuar" me NATO-n, në kuadër të të cilit do të trajtoheshin shqetësime



specifike, reformat politike dhe institucionale, si dhe elaborimi i mundësive për thellimin e partneritetit të strukturuar.

- Kosova do të parashtrijë kërkesë formale për anëtarësim direkt në NATO.
- **Publike dhe Diplomatiqe:**
  - Kosova duhet të përfshihet fuqishëm në procese afirmimi me vendet jonjohëse, si dhe për këtë qëllim të kërkojë mbështetjen aktive të vendeve lidere të NATO-s, që t'i hapet rruga anëtarësimit.
  - Përgatitja e një platforme për përfshirje në diskutime dhe shkëmbime të drejtpërdrejta përmes vizitave, pjesëmarrjes në ngjarje apo forume, me vendet jonjohëse dhe hezituese. Theks i veçantë duhet vënë në diplomacinë parlamentare dhe në mundësitë e bashkëpunimit përmes platformave publike dhe joqeveritare.
  - Nxjerrja periodike e materialeve publikuese në fushën e sigurisë, në autorësi FSK – KFOR, të cilat shpërndahen nga shërbimi diplomatik në institucionet e sigurisë në vendet nikoqire.

#### **Operative dhe Teknike:**

- Thellimi i bashkëpunimit me KFOR-in. Kosova duhet që përmes një komunikimi të ngushtë të hartojë një dokument të përbashkët me këtë mision, përtej mandatit të tij tradicional/standard, ku do të parashiheshin ushtrime të përbashkëta, trajnime dhe programe për ngritje kapacitetesh.
- Përgatitja e dokumentit strategjik të shoqëruar me plan veprimi përkitazi me objektivat e lartcekura.
- Pjesëmarrja në misione të NATO-s: Rritja e angazhimit të Kosovës në misionet ndërkombëtare të NATO-s për të

kontribuar në paqen dhe stabilitetin global.

- Rritja e buxhetit të mbrojtjes: Përcaktimi i një buxheti të qëndrueshëm dhe të mjaftueshëm për FSK-në për të përmbushur detyrat e saj të reja si pjesë e NATO-s.
- Modernizimi i infrastrukturës ushtarake: Investime në infrastrukturën ushtarake për të përmirësuar kapacitetet dhe gatishmërinë e FSK-së.
- Trajnimi dhe pajisjet: Përmirësimi i trajnimit të personelit dhe pajisja e FSK-së me teknologji dhe pajisje moderne për të përmbushur standardet e NATO.
- Përfshirja në nisma bashkëpunimi: Përmbyllja e një numri të marrëveshjeve mes FSK-së dhe NATO-s, vendeve anëtare, në ofrimin e trajnimeve të avancuara në fusha specifike të sigurisë, përmes programeve të rregullta dhe atyre të dizajnuara.
- Menaxhimi i krizave përmes krijimit të një mekanizmi të integruar për menaxhimin e krizave, që do të mundësojë reagimin e shpejtë dhe efektiv ndaj emergjencave dhe fatkeqësive natyrore.

## **Bashkimi Evropian**

**Konteksti, Sfidat, Mundësitë** - Procesi i integritimit në BE është ngushtë i lidhur me performancën dhe zhvillimin ekonomik. Asnjë vend i këtij blloku nuk ka një disbalanc tregtar aq të madh sa Kosova. Asnjë nga këto vende nuk ka normën e lartë të papunësisë që ka Kosova. Asnjë nga këto vende nuk ka shifra të migrimit të cilat, nëse vazhdojnë, mund të rrezikojnë performancën e sektorëve vitalë si arsimit dhe shëndetësisë, dhe asnjë nga këto vende nuk ekspozon një mungesë të theksuar të profilit ekonomik apo mungesën totale të

asaj që njihet si 'Nation Branding'.

Në një ekonomi globale, pavarësisht se Kosova aspiron të bëhet vend anëtar i BE-së dhe NATO-s, nuk mund të pritët që ky proces vetvetiu të ndryshojë parametrat e zhvillimit social apo ekonomik, dhe as nuk mund të pritët që BE do ta zgjidhë këtë përmes një Pakoje të vetme Financiare në përkrahje të Kosovës. Në fakt, mbështetja financiare nga ana e BE-së duhet të konceptohet më shumë si inkurajim në këtë drejtim.

Por ajo që ka rëndësi është që të dy këto organizata, mes tjerash, mund t'i shërbejnë përcjelljes së një porosie në nivel global, që Kosova, përpos që është një vend (pro)evropian, është njëkohësisht një shtet funksional, demokratik dhe shtet i së drejtës. Këto janë parakushte për tërheqjen e investimeve ndërkombëtare apo për t'u mundësuar operatorëve vendorë ekonomikë një depërtim në tregjet e huaja.

Kosova nuk ka një agjendë të krijimit të kushteve të favorshme për investitorë të huaj dhe as për investime strategjike. Aktualisht, Kosova nuk ka asnjë element të aplikimit të diplomacisë ekonomike dhe as asaj publike. Fatkeqësisht, potenciali i fuqishëm i diasporës është reduktuar në remitanca apo në ndonjë investim modest nga koha në kohë. Kjo gjendje duhet të ndryshojë përmes një qasjeje të strukturuar në nivel qendror dhe atë lokal.

Viteve të fundit po shohim një demonstrim në rritje të skepticizmit të aktorëve joqeveritarë dhe publikut përkitazi me ritmin e integritit, por edhe me vetë rolin e aktorëve vendorë. Një rol skajshmërisht destruktiv në këtë mes po luajnë aktorë që përdorin taktika hibride, e këtu bën pjesë Serbia dhe mbështetësit e saj në nivel ndërkombëtar.

Përderisa pas shpalljes së pavarësisë, opinionit të GJND-së, përmbylljes së MSA-së, ishte krijuar një momentum dhe konsensus deri diku institucional, me kalimin e kohës, temat e ndjeshme sikurse dialogu, krijimi i gjykatës speciale dhe joefikasiteti i saj, obstrukcionet

e Serbisë në dialog dhe roli i ndërmjetësve të BE-së në këtë mes, gjithnjë të shoqëruara me propagandë serbe, i kanë dhënë hapësirë të shtuar një klime ku energjitë publike, socio-politike po shterohen me tema jo prioritare.

Është skajshmërisht e vështirë për çdo proces, sikurse integrimi evropian, kur si rezultat i mungesës së konsensusit nacional, mungon përkushtimi i cili në njërin anë motivon përpjekjet institucionale, përderisa në anën tjetër i jep forcë kërkesës për llogaridhënie dhe përgjegjësi.

Kosova ka nevojë për një kulturë dialogu publik dhe politik, në të cilin akterët shohin se ku janë pikëtakimet dhe cilat janë mundësitë për ndërveprim dhe sinergji. Kjo njëkohësisht kërkon që krahas një fryme konsensuale të krijohet edhe një agjendë nacionale, e cila minimalisht i sjell akterët në dakordancë për nevojën e vendosjes së qëllimeve nacionale që duhet ndjekur.

Si rezultat, është e mundur edhe rritja e ndërgjegjësimit qytetar e publik, dhe krijimi i një profili më të avancuar të vendit në rrafshin ndërkombëtar. Në këtë frymë, marrëdhëniet me aktorë joqeveritarë, me publikun, dhe ato që i shërbejnë diplomacisë publike janë një rrugë që duhet ndjekur fuqishëm. Në këtë aspekt duhet investuar në fuqizimin e mediave dhe sektorit joqeveritar, në krijimin e platformave të reja të komunikimit publik dhe institucional, në promovimin e shembujve/modeleve të suksesit, dhe në ndërtimin e fushatave publike për çështje prioritare.



### **Masat dhe Veprimet:**

#### **Politike:**

- Kosova do të përfshihet në komunikim intensiv diplomatik me instancat vendimmarrëse të BE-së, në mënyrë që brenda një afati disa mujor, sanksionet të hiqen, dhe në një periudhë njëvjeçare, aplikimi për anëtarësim në BE të njihet, ashtu që Kosovës, pavarësisht rezistencës eventuale nga ana e vendeve jonjohëse, t'i ofrohet shteg mbi bazën e të cilit Komisioni Evropian do të vlerësonte gatishmërinë për hapjen e negociatave, dhe për rrjedhojë një dokument udhërrëfyes mbi të cilin Kosova do të fokusohet në reforma.
- Paralelisht duhet avancuar komunikimin politik dhe diplomatik, në kuadër të strukturave të përbashkëta të dala nga MSA, Liberalizimi i Vizave, dhe në marrëdhëniet bilaterale e multilaterale.

- Përgatitja e një dokumenti udhërrëfyës për politikë të jashtme dhe diplomaci, përmes të cilit vendet anëtare njoftohen me qasjen konceptuale të Kosovës në lidhje me përfshirjen e saj në rrafshin rajonal, evropian dhe multilateral. Në një dokument të tillë, zbërthehen konceptet, parimet, masat dhe veprimet që udhëheqin lidhshimin shtetëror të Kosovës. Në thelb të një dokumenti të tillë udhërrëfyës vendoset përkushtimi i Kosovës për paqe, progres, demokraci dhe diversitet.
- Hartimi i një Plani Veprimi përkitazi me anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, në kuadër të të cilit institucionet vendore përfshihen në veprime të planifikuara dhe koordinuara. Për këtë qëllim krijohet një Listë e Organizatave Ndërkombëtare, anëtarësimi në të cilat bazohet në kritere si relevanca, dobishmëria, domosdoshmëria dhe afirmimi ndërkombëtar.
- Dizajnimi i një platforme të diplomacisë publike dhe kulturore me vendet jonjohëse të BE-së, në kuadër të së cilës do të shiheshin mundësitë e marrëveshjeve bilaterale me qëllim avancimin e raporteve, bashkëpunimit të ngushtë me SHBA-në dhe vendet lidere të BE-së për të avokuar te këto vende, përderisa në rrafshin e brendshëm, të shihet mundësia e organizimit të ngjarjeve të diplomacisë ekonomike dhe asaj kulturore.
- Përfshirja aktive në një dialog të formatizuar politik në Bruksel. Bashkëpunimi me universitete dhe entitete prestigjioze të njohura për ofrimin e programeve ekonomike dhe negociuese, me qëllim vlerësimin e paanshëm dhe të mbështetur në ekspertizë të arritjeve dhe sfidave në zbatimin e marrëveshjeve të deritashme, teknike dhe asaj gjithëpërfshirëse.
- Ndërtimi i një rrjeti të lobimit dhe urave të komunikimit tematik me organizata pan-evropiane, të cilat do të elaboronin

mundësitë që paraqet dialogu, duke i afirmuar ato pranë institucioneve qendrore evropiane.

- Ndërtimi i programeve në nivel vendi, të cilat inkurajojnë projekte investive, qeverisëse, kulturore, në rrafshin e bashkëpunimit ndërkomunal, ndëretnik, dhe ndërqeveritar. Përkrahja e projekteve kapitale dhe veçanërisht atyre të gjenerimit të punësimit të qëndrueshëm, ku punësimi do të bazohet në elementin etnik, fuqizimin e rinisë dhe fuqizimin gjinor.
- Ndërtimi i një Strategjie të Komunikimit Institucional, e cila do të inkurajonte distancimin nga gjuha e tensionimit, dhe veçanërisht do të elaboronte në detaje dobitë e pjesëmarrjes në jetën politike, publike e civile të komunitetit joshumicë.

### **Funksionale dhe Teknike:**


- Krijimi i një Strategjie të Fuqizimit të Reformave në Drejtësi, me qëllime të qarta për forcimin e pavarësisë së gjyqësorit, transparencës dhe llogaridhënies, dhe veçanërisht në forcimin e efikasitetit të sistemit të drejtësisë.
- Dizajnimi i një kornize të vlerësimit dhe monitorimit kredibil të performancës së sistemit të drejtësisë nga ana e institucioneve të drejtësisë, i asistuar nga qeveria dhe mbështetja ndërkombëtare. Në këtë funksion, identifikimi i sfidave dhe mundësive të cilat institucionet si qeveria, kuvendi, komunat dhe aktorë të tjerë, mund të ofrojnë në këtë drejtim.
- Përgatitja e një Agjende Legjislative, me prioritizim të temave të të bërit biznes, atyre financiare dhe ekonomike, të tregut, dhe temave që lidhen me reformën në drejtësi.
- Dizajnimi i një liste të programeve që targetojnë asistencën teknike në lidhje me nevojën për ngritjen e kapaciteteve

njerëzore dhe institucionale.

- Zhvillimi i një agjende legjislativë, sipas shembullit të vendeve që kanë përshkuar këtë proces, dhe mbi bazën e të cilit do të ndërtohej një databazë e legjislacionit të ri që duhet nxjerrë, dhe harmonizimit të atij aktual me ligjet dhe normat e BE-së (acquis communautaire). Një databazë e tillë do të kishte afate indikative, urgjencën, vlerësimin preliminar mbi kapacitetin për rregullim dhe harmonizim, të shoqëruar me rekomandime për vendimmarrjen institucionale mbi harmonizimin e plotë, të pjesshëm, apo mbi nevojën për krijimin e parakushteve.

## **KONSOLIDIMI INSTITUCIONAL DHE DEMOKRATIK**





**Konteksti, Sfidat, Mundësitë** – Viteve të fundit po vërejmë se institucionet prestigjioze ndërkombëtare kanë vlerësuar se arritjet e Kosovës në fushën e konsolidimit institucional dhe demokratik janë të kufizuara ose mungojnë krejtësisht. Kjo është evidentuar nga raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit, Komisionit Evropian dhe Freedom House. Në mënyrë të ngjashme, kemi parë edhe raporte të organizatave vendore të shoqërisë civile që veprojnë prej vitesh dhe që kanë dëshmuar objektivitet e kompetencë në fusha të ndryshme të politikbërjes dhe jetës institucionale.

Këto organizata kanë sinjalizuar për mosrespektim të vendimeve të gjyqësorit, përhapje të dezinformimit dhe gjuhës së urrejtjes, shkelje të parimit të ndarjes së pushteteve, nëpërkëmbje të përfshirjes civile dhe publike në procese me interes, si dhe për tendenca të monopolizimit të pushtetit dhe vendimmarrjes. Po ashtu, ato kanë treguar se subjektet në qeverisje nuk shfaqin interes për korrigjimin e veprimeve të gabuara dhe as nuk u kushtojnë vëmendje kërkesave për transparencë e llogaridhënie.

Në vend që lidhshipi politik dhe institucional i vendit, veçanërisht ai në qeverisje, të mbledhë forcat dhe energjitë për të adresuar kërkesat kulturore e strukturore të nevojshme për konsolidim institucional dhe demokratik, ai ka shpenzuar energji në përplasje, polarizim dhe defaktorizim të faktorit politik e njerëzor. Si pasojë, edhe shoqëria civile, deri dje e konsoliduar, si dhe media e lirë, e kanë pasur të vështirë t'u kontribuojnë proceseve të reformave.

Kjo situatë ka rezultuar me mungesë të vullnetit politik të nevojshëm për reforma afatgjata, si dhe me apati në aspektin e pjesëmarrjes civile, për të mos folur për qytetari aktive.

## **Masat dhe Veprimet**

Kosova ka hyrë në një fazë ku subjektet politike, mediatike dhe civile, duke bashkëpunuar veç e veç, mund të ngriten në një nivel

tjetër. Njëkohësisht, ato mund t'i shërbejnë një kauze dhe vizioni ku Kosova reflekton imazhin e një vendi demokratik dhe modern.

### **Politike:**

- Avancimi i kornizës ligjore, përmes së cilës inkurajohen partitë politike, organizatat joqeveritare dhe mediat e lira, të instalojnë dhe projektojnë praktika të konsultimeve, pjesëmarrjes aktive, transparencës dhe llogaridhënies së brendshme.
- Identifikimi dhe instalimi i praktikave të konsultimit të rregullt mes partive politike dhe partnerëve, siç janë: organizatat e shoqërisë civile, mediat, partnerët socialë dhe entitetet përfaqësuese të bizneseve.
- Inkurajimi i akterëve joqeveritarë dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve të edukimit të hershëm për ofrimin e programeve të edukimit civil dhe politik, me theks në rëndësinë e respektimit dhe afirmimit të të drejtave të njeriut, qytetarisë aktive, vlerave universale, respektit për vlerat dhe arritjet kulturore e historike, si dhe rëndësinë që kanë institucionet për lirinë dhe proceset demokratike.
- Kosova në të gjitha nivelet do të zhvillojë kode të avancuara të etikës, luftimit të korrupsionit dhe klientelizmit në të gjitha instancat. Për këtë do të dizajnohen programe dhe trajnime të mbështetura në modele dhe ekspertizë ndërkombëtare.
- Do të instalohen praktika të promovimit të modeleve, sjelljeve dhe shembujve individualë të suksesshëm në luftimin e këtyre dukurive.
- Forcimi i diplomacisë: Zhvillimi i kapaciteteve diplomatike të Kosovës për të promovuar interesat kombëtare në arenën ndërkombëtare.

## **Shteti i së Drejtës:**

Sundimi i ligjit është vendosur si prioritet kryesor i qeverisjes. Angazhimi për ndërtimin e një qeverisjeje demokratike, gjithëpërfshirëse dhe efektive që do t'i shërbejë popullit të Kosovës pa diskriminim, fillon me një sundim të fortë të ligjit.

Në adresimin e sundimit të ligjit si çështje komplekse, ne kemi identifikuar një qasje më të koordinuar, veçanërisht duke zbatuar implementimin e disa niveleve të politikave:

- Llogaridhënia në sundimin e ligjit;
- Kthimi i dinjitetit dhe pavarësi i institucioneve të sundimit të ligjit;
- Përgjegjësia institucionale efektive;
- Drejtësi e pavarur;
- Intervenimet e drejtpërdrejta në politikat publike të sundimit të ligjit dhe drejtësisë.

## **Civile dhe mediatike:**

- Avancimi i kornizës ligjore për mbrojtjen e lirisë së medias, përfshirë inkurajimin e diversitetit në hapësirën mediatike.
- Reformimi i transmetuesve publikë, me qëllim forcimin e pavarësisë së tyre nga qeveria.
- Instalimi i një mekanizmi të pavarur nga institucionet, përmes të cilit mediat dhe shoqëria civile garojnë me projekte që përkrahin demokratizimin, progresin dhe zhvillimin institucional e njerëzor. Në këtë kontekst do të ketë një sekuencim të veprimeve. Në një periudhë 5-vjeçare, ky mekanizëm do të mbështetet në replikimin e programeve të

përkrahura nga partnerë dhe donatorë ndërkombëtarë. Njëkohësisht, që procesi i ofrimit të përkrahjes së projekteve të jetë plotësisht i pavarur dhe i pandikuar nga subjektet politike dhe institucionet qeveritare, do të shqyrtohen modalitetet që përfaqësuesit në të të jenë nga komuniteti demokratik ndërkombëtar.

- Lirimi nga taksat; dhënia e granteve dhe format e tjera të përkrahjes do të jenë pjesë e programit tonë qeverisës.
- Do të krijohet një platformë e rregullt konsultimi, e hapur për publikun, me institucionet e luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, për të identifikuar vështirësitë.
- Avancimi i platformave të e-qeverisjes me qëllim përmirësimin e transparencës, vlerësimin e cilësisë së shërbimeve dhe reduktimin e influencës përmes qasjes burokratike. Për këtë qëllim do të hartojmë një strategji e cila mbështetet në arritjet e deritashme dhe njëkohësisht ofron mundësi të reja të bazuara në modele të avancuara në vende të tjera.
- Fuqizimi i institucioneve të pavarura si Avokati i Popullit, Auditori i Përgjithshëm, Agjencia Kundër Korrupsionit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, e kështu me radhë.
- Mbështetja e projekteve të cilat vlerësojnë cilësinë e shërbimeve, performancën administrative, përmes metodave të vlerësimit të opinionit dhe pjesëmarrjes.
- Fuqizimi i partneritetit mes institucioneve qendrore dhe atyre komunale, me fokus fuqizimin e proceseve civile dhe demokratike, duhet të shoqërohet me masa specifike dhe t'u përgjigjet pritjeve qytetare në terren.
- Implementimi i një programi të rehabilitimit dhe risocializimit të të burgosurve me kushte më të mira.

- Krijimi i një infrastrukture të pavarur për domenet shtetërore. Vendosja e një qendre të pavarur të regjistrimit dhe menaxhimit të domeneve shtetërore që të sigurojë kontrollin e plotë mbi domenin ".kos" dhe domenet e tjera të nivelit të lartë kombëtar. Kjo qendër do të ofrojë shërbime të regjistrimit dhe menaxhimit të domeneve në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe do të ndihmojë në mbrojtjen e identitetit digjital të Kosovës.
- Platforma kombëtare për transparencë në qeverisje: krijimi i një platforme digjitale që u lejon qytetarëve të monitorojnë shpenzimet publike dhe projektet e qeverisë në kohë reale, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien.
- Trajnimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional për të gjithë nëpunësit publikë për t'u siguruar që ata janë të pajisur me mjetet, metodologjitë dhe njohuritë më bashkëkohore në fushat përkatëse, me qëllim ofrimin efikas dhe efektiv të shërbimeve për qytetarët e Republikës së Kosovës.

## ***NDËRTIMI I IMAZHIT DHE PROFILIT SHTETËROR***



Kosova po vuan pasojat e mungesës së një profili të qartë në nivel ndërkombëtar. Periudha para pavarësisë është shoqëruar me paqartësi. Periudha pas pavarësisë ka shënuar një tendencë profilizimi në vitet e para, të cilat u asociuan me suksese si njohjet, opinioni i GJND-së, anëtarësimi në organizata ndërkombëtare të karakterit financiar, zhvillimor, kulturor e sportiv. Kjo periudhë filloi të shënonte rënie, e cila kulmoi me pengimin e anëtarësimit të Kosovës në UNESCO, INTERPOL, dhe me pretendimet e fabrikuara nga Raportuesi i Këshillit të Evropës, që rezultuan në themelimin e Dhomave Speciale.

Sikur të mos mjaftonte kjo, në vitet e fundit kemi parë një komunikim negativ, lajme të rreme dhe një vëmendje negative ndërkombëtare në raport me Kosovën. Kjo ka arritur në nivelin më të ulët të degradimit, saqë dikush mund të mendojë se mund të mbjellë farën e urrejtjes anti-perëndimore në Kosovë. Kjo duhet të marrë fund menjëherë.

Nisur nga ky kontekst dhe kjo klimë toksike, Kosova përballet me vështirësi të lidhura me imazhin e saj global, me sfida në mirëmbajtjen, avancimin dhe afirmimin e marrëdhënieve bilaterale dhe multilaterale, si dhe me vështirësi në qasjen ndaj tregjeve dhe investimeve ndërkombëtare të nevojshme për zhvillim ekonomik.

Ndërtimi i imazhit dhe profilit shtetëror kërkon krijimin dhe afirmimin e narrativave, porosive, imazhit dhe mundësive të shtetit për të tërhequr investime, vizitorë, njohje të reja, si dhe përfshirje më të madhe në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

**Masat dhe Veprimet** – Kosova duhet të njohë limitet dhe sfidat që gjenerojnë efekte negative në lidhje me imazhin dhe profilin ndërkombëtar. Duke njohur ato, Kosova duhet të fokusohet në masa dhe veprime specifike që ndryshojnë këtë realitet në secilin nivel:

- Kosova është njohur nga mbi 100 vende. Numri i njohjeve i afrohet numrit kritik të nevojshëm për sigurimin e 2/3 në




platforma multilaterale në përkrahje të saj. Në rrafshin politik dhe diplomatik, argumentet dhe narrativa për nevojën e njohjeve të reja burojnë nga kërkesat për afirmim, dhe si të tilla nuk duhet të plasohen nga një pozicion zhgënjyes apo inferior. Mesazhi duhet të jetë i qartë: Kosova është shtet, Kosova ka pranuar njohje të shumta substanciale. Njohjet e reja janë proces i afirmimit të pozitës së saj dhe i marrëdhënieve ndërkombëtare.

- Kosova duhet të ndërtojë një Strategji të Komunikimit Publik dhe Institucional, ku referencat ndaj luftës, lirisë, pavarësisë dhe menaxhimit të sfidave aktuale të sigurisë nuk krijojnë asnjë potencial rreziku për investimet e huaja apo vizitorët potencialë.
- Është urgjente që Kosova të investojë në përgatitjen e evidencës së potencialit të saj ekonomik, investues dhe turistik. Mungesa e një profili të veçantë për ekonominë e saj dhe sektorët e bën të vështirë, për të mos thënë të pamundshme, rritjen e investimeve të huaja direkte dhe atyre nga diaspora. Kjo mund të ndryshojë përmes një Partneriteti Publiko-Privat, ku kompanitë vendore apo ndërkombëtare do t'u bënin PR dhe Marketing modeleve, shembujve, sektorëve, praktikave, nismave, natyrës, etj. Kjo mund të realizohet në muajt e parë të qeverisjes.
- Përderisa akterë vendorë dhe rajonalë shpesh përçojnë shembuj negativë, të cilët rezultojnë me të ashtuquajturin 'negative branding' lidhur me rastet e krimit të organizuar, korrupsionit apo zhvillime të tjera, një partneritet me median dhe shoqërinë civile është i domosdoshëm për të parë format e bashkëpunimit në promovimin e sukseseve.
- Kosova do të zhvillojë një Strategji të 'Nation Branding', e cila do të jetë e informuar, e koordinuar dhe do të përfshijë akterë

e ekspertizë ndërkombëtare. Kjo do të ndodhë në gjashtë muajt e parë të qeverisjes.

- Një 'Plan Veprimi' në funksion të "Nation Branding" do të përmbajë një Strategji të Komunikimit në nivel vendor, Përfshirjen e Diasporës, Zhvillimin e Turizmit, Zhvillimin e Diplomacisë Publike e Ekonomike, dhe Afirmimin e Arritjeve Qeverisëse dhe Demokratike.
- Do të krijohet një fond për të mbështetur projektet artistike të grave të reja dhe të rinjve të talentuar, përfshirë ekspozita, koncerte dhe festivale kulturore, me synimin për të financuar 100 projekte artistike çdo vit.
- Projekti për zhvillimin e fshatrave turistike do të përfshijë investime në infrastrukturën e 20 fshatrave me potencial turistik për të rritur turizmin lokal dhe për të gjeneruar të ardhura për komunitetet lokale.

## *ZHVILLIMI EKONOMIK*



**Konteksti, Sfidat, Mundësitë** – Në katër vitet e fundit, Kosova është varfëruar dhe shndërruar në një vend të vështirë për jetesë. Rritja ekonomike ka qenë e papërfillshme, çmimet e artikujve themelorë janë rritur ndjeshëm dhe kostoja e jetesës është bërë e papërballueshme. Pagat në sektorin publik dhe privat, me pak përjashtime, kanë mbetur në nivelin e katër viteve më parë. Bllokimi i parasë publike për qarkullim dhe përçindja tejet e ulët e investimeve kapitale kanë ndikuar negativisht në zhvillimin e ekonomisë dhe biznesit, duke thelluar varfërinë e qytetarëve.

Situata e vështirësuar energjetike, që ka reflektuar në rritjen e konsiderueshme të çmimit të energjisë, ka qenë një element shtesë rëndues për popullatën. Kjo ka nxitur një valë shqetësuese largimi të qytetarëve nga vendi, duke shkaktuar mungesë të theksuar të fuqisë punëtore. Ekonomia e Kosovës në këtë periudhë është përballur me mungesë vizioni për zhvillim të qëndrueshëm. Programi ynë parasheh hapa që e vendosin Kosovën në rrugën e pakthyeshme drejt zhvillimit të hovshëm dhe të qëndrueshëm ekonomik.

Zhvillimi ekonomik i Kosovës ka mbet më i ulëti në rajon dhe përballet me strukturë të pavolitshme, shkallë të lartë varfërie, papunësi masive, migrim të trurit, varësi të madhe nga importet dhe thellim të deficitit tregtar. Pavarësisht pasurive të konsiderueshme natyrore sidomos të atyre nëntokësore për prodhim energjie, vendi vuan nga mungesa e energjisë. Bruto Produkti Vendor (BPV) për kokë banori është më i ulëti në rajon, paga mesatare vetëm 521 €, pagë minimale 264€ shoqëruar me inflacion enorm të lartë.

Norma mesatare e papunësisë është rreth 36%, ndërsa papunësia e të rinjve arrin 60% kurse papunësia e femrave 83%. Kjo situatë rrezikon të shkaktojë trazira sociale dhe nxit migrimin e kapitalit njerëzor, veçanërisht të grup moshes 20 deri 45 vjec sidomos pas liberalizimit të vizave. Rreth 34% e popullsisë jeton nën kufirin e varfërisë (45 € në muaj) dhe 17% në varfëri ekstreme. Stabiliteti dhe perspektiva zhvillimore e Kosovës varen kryesisht nga

menaxhimi me resurset disponuese/qeverisja/ dhe krijimi i vendeve të punës.

Deficiti i madh aktual (mbi 19% i BPV-së) financohet kryesisht nga ndihmat, remitancat dhe donacionet ndërkombëtare. Kosova është një nga dhjetë vendet me nivelin më të lartë të remitancave, ku 13% e BPV-së vjen nga dërgesat e parave nga jashtë. Megjithatë, vetëm rreth 11% e remitancave shfrytëzohen për investime, ndërsa shumica shkon për konsum.

Aktiviteti ekonomik është përqendruar kryesisht në sektorin e shërbimeve dhe të konsumit. Mungojnë investimet kapitale produktive në sektorët e mallrave tregtare, prodhimtarisë, industrisë së rëndë, minierave, mineraleve dhe bujqësisë, të cilat janë thelbësore për zhvillim ekonomik dhe krijim vendesh pune.

Ne ofrojmë projekte konkrete me ide dhe politika për zhvillimin e këtyre sektorëve ekonomikë, që garantojnë rritje të BPV-së dhe zhvillim të qëndrueshëm për ekonomitë familjare dhe bizneset e vogla e të mesme.

Një raport i fundit për industrinë e rëndë në Kosovë ka identifikuar mungesën e politikave dhe rregulloreve qeveritare efektive, si dhe mungesën e koordinimit, konsistencës dhe transparencës, veçanërisht në vjeljen e tatimeve për resurset natyrore, si pengesë madhore ndaj zhvillimit industrial.

Ekonomia aktuale në Kosovë është e orientuar kah konsumi dhe jo prodhimi dhe industria, që do të garantonin zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe krijim të vendeve të punës. Ne premtojmë krijimin e politikave dhe mjedisit rregullativ më të favorshëm për zhvillimin e sektorëve kyç ekonomikë.

Duke u bazuar në këto të dhëna, kemi identifikuar disa çështje thelbësore lidhur me strukturën e ardhshme të ekonomisë:

- Sa e qëndrueshme është rritja aktuale ekonomike?

- Sa të besueshme janë burimet dhe furnizuesit e kësaj rritjeje?
- A kemi një platformë të re ekonomike të përshtatshme për të garantuar rritje në vitet e ardhshme?
- A kemi një ekonomi orientuese, të degëzuar, të strukturuar dhe rezistente që mund të garantojë zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë?

Ne ofrojmë një platformë me politika zhvillimore që do t'i japin shtysë rritjes ekonomike afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

### **Masat dhe Veprimet:**

Nëpërmjet këtyre politikave ekonomike e fiskale do të plotësohet vakumi që po krijon tkurrjen e disa sektorëve të ekonomisë, zvogëlimi i remitançave, apo "mbarimi" i privatizimeve:

- Do ta monitorojmë, kontrollojmë, zvogëlojmë apo ngushtojmë deficitin tregtar dhe atë të bilancit të pagesave;
- Do ta orientojmë dhe zhvillojmë hapësirën rurale, zhvillojmë bujqësinë dhe përmirësojmë tendencën drejt një tregu aktiv;
- Do ta zhvillojmë, përkrahim, ristrukturojmë e modernizojmë biznesin vendor që kryesisht dominohet nga bizneset e vogla e të mesme dhe do të reagojmë agresivisht në luftimin e ekonomisë informale dhe evazionit fiskal;
- Do të ndërtojmë planin strategjik të ekonomisë për vitet në vazhdim, të identifikuar nëpërmjet disa sektorëve prioritarë të zhvillimit ekonomik si energjia, bujqësia dhe agroindustria, arsimit dhe shërbimet e tjera publike;
- Do të zhvillojmë dhe zbatojmë politika të fuqishme për lehtësira të zhvillimit ekonomik, të orientuara për nxitjen maksimale të rritjes ekonomike, për garantimin e

qëndrueshmërisë së saj, që sigurojnë rritjen e prodhimit vendor dhe eksporteve, hapjen masive të vendeve të reja të punës;

- Do të identifikojmë qartë faktorët e rinj të rritjes ekonomike që, me anë të mbështetjes së sektorëve prioritarë dhe politikave e masave specifike, t'i kthejmë në avantazhe konkurruese;
- Do të vendosim një koordinim dhe bashkëpunim të përhershëm me komunitetin e biznesit, vendor dhe të huaj, si dhe me ekspertë të ndryshëm vendorë e ndërkombëtarë si konsulencë.

## Politikat makroekonomike dhe fiskale

**Konteksti, Sfidat, Mundësitë** – Te hyrat dhe shpenzimet publike ndikojnë drejtpërdrejt në performansat e përgjithshme ekonomike, meqë ato përbëjnë një pjesë të madhe të aktivitetit në ekonominë kombëtare. Politika fiskale bashkë me politikat kreditore janë dy komponente themelore të politikës ekonomike shtetërore të cilat shfrytëzohen për qëllime makro-ekonomike: influencimin e produktit të përgjithshëm vendor, nivelin e punësimit, të ardhurat dhe nivelin e çmimeve.



## Masat dhe Veprimet:

- Do të ndërtojmë politika aktive fiskale me tatime të ndershme.
- Do të zhvillojmë politike fiskale që do të garantojnë respektimin e stabilitetit buxhetor dhe do të sigurojm kontrollin e nivelit të lejuar të borxhit publik deri në nivelin e pranueshëm për një vend në zhvillim, që nuk rrezikon zhvillimin dhe stabilitetin afatgjatë;
- Do të zhvillojmë politika fiskale që do prodhojnë më shumë qëndrueshmëri fiskale e zhvillimore. Këto politika do të kenë në fokus rritjen e efikasitetit të shpenzimeve publike, prioritetin e shpenzimeve me efekte sa më të gjëra dhe të shpejta, hapjen e perspektivave të reja për investime nga sektori privat, të prira nga përfitime e rritje ekonomike, dhe punësimi;
- Do të ofrojmë dhe zbatojmë politika fiskale të platformës së re ekonomike që ka si pikësynim të mbështesë zhvillimin ekonomik dhe të rrisë punësimin. Objektivat dhe mbështetjen e politikave afatmesme do t'i orientojmë:
  - o Për përmirësimin e ambientit afarist dhe të bërit biznes;
  - o Për uljen e taksave, tatimeve dhe thjeshtësimin e sistemit tatimor e fiskal;
  - o Për lehtësimin dhe uljen e presionit fiskal;
  - o Për strukturimin, konsolidimin e biznesit në Kosovës duke selektuar apo strukturuar biznesin në Kosovë të cilat do të përbëjnë skeletin bazë të zhvillimit ekonomik në Kosovës;
  - o Për realizimin e pagesave për rimbursim të TVSH-së të parapaguar;



- o Për nxitjen e investimeve të brendshme dhe të huaja në sektorin privat dhe zhvillimin e vendit;
- Eliminimi maksimal të ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal dhe futja e saj në rrjedha legale, dhe këtë duke i dhënë përparësi politikës stimuluese tatimore ndaj asaj represive;
- Rregullativa ligjore të jetë në funksion të efikasitetit, duke thjeshtësuar procedurën përcaktimin dhe inkasimin e të hyrave fiskale, duke siguruar zbatimin e parimit të barazisë së obliguesve fiskal;
- Lehtësimet nga tatimi në fitim të korporatave, aplikimi me përparësi për investimet në sektoret prioritarë që sigurojnë produktivitet të lartë dhe punësim dinamik.

### **Politika racionale fiskale**

- Përgjysmim të TVSH-së për të gjitha ushqimet më jetike të shportës, bazë të konsumit;
- Përjashtim/ ulje nga ky tatim për barnat dhe shërbimet shëndetësore;
- Ulje/ kompensim të TVSH-së për pjesën e domosdoshme të furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve me asistencë, familjet e dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës së UÇK-së;
- Reduktim të TVSH për farërat, fidanët, materialin gjenetik shtazor, plehrat kimike, pesticidet, vaksinat e blegtorisë dhe për lëndët e tjera të para që përdoren në bujqësi dhe blegtori etj;
- Heqja ose zvoglimi i akcizës dhe taksës së naftës për bujqësinë;

- Rritje e pragut për regjistrim në TVSH nga 30,000 € sa është aktualisht në 50,000€ me mundësi të rritjes në 100,000€ deri në fund të mandatit;
- Tatimi mbi fitimin i korporatave do të ndryshohet dhe përshtatet me nevojën që kompanitë e mëdha të kontribuojnë më shumë se bizneset e vogla që funksionojnë nëpërmjet vetëpunësimit;
- Tatimi mbi të ardhurat personale të individëve do të ndryshohet në një skemë të normave progresive, duke rritur ngarkesën fiskale për pagat më të larta dhe duke e ulur për pjesën tjetër.

#### **Partneriteti me bizneset:**

- Vendosje e drejtësisë sociale përmes taksimit progresiv për të ardhurat personale;
- Zbatim i parimit kush paguhet më pak do të paguajë me pak – kush paguhet më shumë do të paguajë me shumë;
- Politikë e re fiskale në funksion të uljes së kostos së jetesës për shumicën e qytetarëve;
- Rishikim në mënyrë të plotë të gjithë sistemit të tarifave;
- Politika fiskale të përputhëshme me platformën e re ekonomike dhe kontribuese në lehtësimin e gjendjes kritike ku ndodhet ekonomia e vendit;
- Politika tatimore që synojnë lehtësimin e menjëhershëm të barrës ekonomike të familjeve me të ardhura të ulëta e të mesme;
- Taksim real si kontribut për më shumë investime publike, më shumë vende pune dhe më shumë kërkesë konsumatorë;

- Ndryshim radikal në menaxhimin e shpenzime publike dhe në efikasitetin e përdorimit të parave e pasurisë publike, përmes zbatimit me sukses të politikave fiskale.

Politikat fiskale do fokusohet në promovimin e barazisë ekonomike dhe në mbështetjen e shërbimeve publike dhe mirëqenies sociale, këto politika synojnë të krijojnë një sistem më të drejtë ekonomik dhe shoqëror, ku burimet janë të shpërndara në mënyrë të barabart dhe ku mbështetet zhvillimi afatgjatë dhe qëndrueshmëria sociale dhe ekonomike.

**Disa nga karakteristikat kryesore të këtyre politikave buxhetore përfshijnë:**

- Rritja e shpenzimeve publike për shërbime sociale si shëndetësia, arsimi dhe mirëqenia sociale;
- Rritja e investimeve në infrastrukture ekonomike, infrastrukture të standardit jetësor, strehimit publik dhe projekteve tjera publike për të stimuluar ekonominë dhe për të krijuar vende të reja pune.

## **Reduktimi i informalitetit dhe evazionit fiskal**

**Konteksti, Sfidat, Mundësitë** – Forcimi i masave kundër informalitetit, evazionit fiskal dhe shmangies së taksave për të siguruar që të gjithë paguajnë pjesën e tyre të drejtë. Kosova ka një sistem tatimor që përfshin tatimet mbi të ardhurat personale, tatimet mbi të ardhurat e korporatave, tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH), tatimet mbi pronën ,taksa per sherbime, për shfrytëzim të pasurive publikedhe kontribute të ndryshme sociale.

Ne do të kemi parasysh zgjerimin, plotësimin me disa tatime të tjera që nuk janë aplikuar ende dhe mund të ndihmojnë në diversifikimin e të ardhurave shtetërore si:

- Tatimi mbi të ardhurat nga kapitali
- Tatimi mbi karbonin
- Tatimet mbi luksin dhe ndotjen
- Tatimi mbi transaksionet financiare
- Tatimi mbi aktivitetet digjitale – shitblerjet online

Këto tatime do mund ta ndihmojnë në zgjerimin e bazës tatimore dhe në përmirësimin e financave publike në Kosovë. Megjithatë, është e rëndësishme të merret parasysh ndikimi që mund të kenë në ekonomi dhe të sigurohet një proces i drejtë dhe transparent.



Me politika aktive fiskale do të sigurojmë rritjen e zhvillimit ekonomik për më shumë të ardhura, një jetë dinjitoze e përfshirje në jetën ekonomike të të gjithë qytetarëve, duke vënë theksin tek bizneset e vogla, të mesme, tek familjet produktive, fshat dhe forca punëtore që shtyn përpara zhvillimet pozitive të vendit.

Përmes politikave të ndershme ekonomike synojmë:

- Rritje ekonomike mesatarisht deri në 7% në vit;
- Konsolidim i sistemit fiskal duke synuar stabilitet afatgjatë buxhetor,
- Rritje të të hyrave buxhetore,dhe
- Rritje të pagës minimale deri në 500€, dhe pagës mesatare mujore 1000€;
- Rritje të pagave të administratës publike çdo vit në përputhje me rritje ekonomike dhe shkallen e inflacionit;
- Pershtatje e vlerës së koeficientit me ecurit ekonomike.
- Pensione të dinjitetshme baraz me pagën minimale;
- Rritje të pagave të mësuesve, mjekëve dhe infermierëve me 50%;
- Rritje të pagave të Policisë dhe Ushtarit të FSK me 45%;
- Fillim të pagesës së sigurimit shëndetësor me 1.5% - 2.5% për të punësuarit dhe punëdhënësit.

## Lehtësirat fiskale

**Konteksti, Sfidat, Mundësitë** – Zhvillimi dinamik dhe i qëndrueshëm, i bazuar në burimet e disponueshme dhe potencialin njerëzor, do të mundësohet duke krijuar një mjedis të përshtatshëm institucional dhe biznesor. Për tejkalimin e problemeve si varfëria, papunësia dhe struktura e pavolitshme ekonomike, nevojitet sigurimi i një rritjeje ekonomike prej së paku 7% mesatarisht në vit. Në

mandatin qeverisës 2025-2028, si rezultat i politikave aktive dhe masave për zhvillim më dinamik, bruto produkti vendor do të rritet nga 10,5 miliardë që është këtë vit, në 14 miliardë në fund të mandatit të ardhshëm, i shprehur në terma realë. Kjo dinamikë e rritjes ekonomike do të mundësojë rritjen e të hyrave buxhetore nga 3 miliardë, sa planifikohen këtë vit, në mbi 5 miliardë në fund të mandatit.

Duke siguruar stabilitetin buxhetor dhe pa ndryshuar normat tatimore, përmes eliminimit të evazionit fiskal, informalitetit dhe korrupsionit të theksuar të strukturave shtetërore, do të sigurojmë që me këtë buxhet të dyfishojmë fondin e pagave për sektorin publik, të dyfishojmë buxhetin për investimet kapitale dhe të rrisim ndjeshëm fondet për rritjen e pensioneve dhe transfereve sociale. Rritja e investimeve kapitale deri në 1,5 miliardë euro dhe krijimi i kushteve për investime të huaja, por edhe të brendshme, së bashku me mundësitë e pashfrytëzuara për hua publike, do të mundësojnë që investimet e përgjithshme vjetore të arrijnë në mbi 7 miliardë euro në vit.

Do të përfundojë procesi i privatizimit dhe mjetet e siguruar do të investohen në ristrukturim dhe modernizim të ekonomisë. Me masa të politikave aktive fiskale do të nxisim rritjen e eksportit dhe zëvendësimin e një pjese të importit me produkte vendore. Do të sigurojmë zvogëlimin e deficitit tregtar me jashtë. Përmes politikave sociale do të rrisim përkrahjen për familjet në nevojë dhe të gjitha skemave sociale do t'u garantojmë rritje proporcionalisht me rritjen ekonomike. Rritja e mesatares së pagave mujore në sektorin publik do të shkojë në mbi 1000 euro, ndërsa në sektorin privat në mbi 900 euro. Paga minimale do të caktohet në 500 euro dhe do të vazhdojë të rritet sipas dinamikës së rritjes ekonomike ndër vite.

Këto ndryshime do të ndikojnë në përmirësimin e standardit jetësor, por sidomos në ndaljen e eksodit të të rinjve nga vendi. Në

kuadër të politikave sociale, kujdes i veçantë do t'u kushtohet kategorive të lirisë, të cilat do të trajtohen me ligj të veçantë. Veteranëve do t'u mundësohet të punojnë pa iu zbritur pensioni. Do të sigurojmë po ashtu një mbështetje mujore financiare prej 300 euro për familjet pa asnjë të punësuar.

### **Masat dhe Veprimet:**

Lehtësirat fiskale janë një komponent i rëndësishëm për mbështetjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve në Kosovë. Qëllimi i kësaj ndihme është të mirëmbahet likuiditeti i ndërmarrjeve dhe të krijohen kushte më të favorshme për bizneset që të rriten dhe të zhvillohen. Këto masa do të ndihmojnë në përmirësimin e klimës së biznesit dhe do të kontribuojnë në krijimin e një ekonomie më të qëndrueshme dhe konkurruese.

- TVSH pas shitjes: Për një vit prej ardhjes në qeveri, e gjithë mbledhja e TVSH-së do të bëhet pas shitjes dhe në brendësi të vendit, masë kjo e cila do ta ndihmojë likuiditetin e biznesit.
- Tatimi progresiv: Shuma në nivel të pagës minimale lirohet tërësisht nga tatimi. Skema e re progresive tatimore:
  - o 500-1000 euro tatóhen me 8%.
  - o Mbi 1000 euro tatóhen me 10%.
- Për investitorët në sektorët strategjikë, lirimi nga tatimi në fitim dhe në të ardhura personale deri në tre vjet.
- Zbritja e akcizës për naftë për makineritë bujqësore dhe të prodhimit të industriale.

### **Lehtësirat Fiskale për investitorët:**

- Për investitorët që investojnë mbi 5 milionë € në sektorin e prodhimit dhe hapin mbi 10 vende të reja pune, do të kenë lehtësira në disa prej politikave fiskale si taksa dhe tatime ne fitim deri në 3 vite;
- Për investitorët që investojnë deri në 10 milionë € në sektorin e prodhimit dhe hapin deri në 100 vende të reja pune, do të kenë lehtësira në disa prej politikave fiskale si taksa dhe tatime deri në 5 vite;
- Për investitorët që investojnë mbi 10 milionë € në sektorin e prodhimit dhe hapin mbi 100 vende të reja pune, do të kenë lehtësira në disa prej politikave fiskale si taksa dhe tatime deri në 5 vite.

## **Luftimi i korrupsionit, ekonomisë informale dhe evazionit fiskal**

**Konteksti, Sfidat, Mundësitë** – Ekonomia joformale çrregullon konkurrencën e drejtë, zvogëlon konkurrencën midis ndërmarrjeve dhe dobëson besueshmërinë e sistemit financiar. Shkalla e evazionit fiskal në Kosovë është e lartë, me studime që sugjerojnë se mbi 30-40% e të ardhurave potenciale tatimore mund të humbasin për shkak të informalitetit; apo (kalkulimi me 35%) rreth 3.2 miliardë e BPV dhe rreth 1.2 miliardë euro e Buxhetit të Kosovës, ky fenomen është një sfidë e madhe për financat publike dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.

**Parandalimi i ekonomisë joformale, korrupsionit dhe formave tjera të ekonomisë së hirtë, janë prioritete të politikave tona. Ne do të ndërmarrim masa të prera ligjore për të:**

- Përmirësuar klimën për bizneset dhe investimet;
- Joshur dhe inkurajuar investimet private kombëtare dhe huaja direkte;



- Siguruar përfshirjen e sektorit privat në procesin reformues;
- Zvogëluar çrregullimin e tregut të fuqisë punëtore dhe konkurrencën e padrejtë;
- Siguruar zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e strukturave bazë të shoqërisë.



### **Masat dhe Veprimet:**

- Parandalimi, reformimi dhe ndërtimi i infrastrukturës ligjore me standarde europiane
- Përforcimi i përgjegjësisë dhe pavarësisë së mekanizmave institucionale
- Ndërgjegjësimi institucional dhe qytetar në zbatimin e ligjeve
- Masat ndëshkuese ndaj shkelësve të ligjeve në fuqi
- Modifikimi i legjislacionit ekzistues dhe propozimi i infrastrukturës së re ligjore
- Hartimi i politikave shtetërore dhe zbatimi i masave konkrete, përfshirë përmirësimin e sistemeve të qeverisjes elektronike

- Hartimi i një Strategjie dhe Plani të Veprimit Shtetëror kundër Korrupsionit, evazionit fiskal dhe ekonomisë informale
- Krijimi i institucioneve të reja në luftimin e këtyre dukurive

Ne kemi qëndrim të fuqishëm dhe një përkushtim të pakompromis për zbatimin e të gjitha masave preventive ligjore në luftën kundër korrupsionit, evazionit fiskal dhe ekonomisë informale.



### **Prodhimi vendor dhe rritja e eksporteve:**

Meqenëse duam të nxisim rritjen ekonomike afatgjatë, nuk duhet të fokusohemi vetëm te politikat fundamentale të programeve të rregullave dhe përshtatjeve ekonomike. Në vend të kësaj, do të përqendrohemi konkretisht drejt politikave prodhuese, veçanërisht atyre ekonomike, energjetike, industriale dhe bujqësore. Do të zhvillojmë politika të posaçme për mbështetjen e eksporteve, duke monitoruar njëkohësisht stabilitetin financiar.

Angazhimi ynë do të përfshijë futjen e inovacioneve dhe teknologjive të reja në të gjithë sektorët e ekonomisë, si dhe zgjerimin e kapitalit njerëzor për një përfshirje më të gjerë të popullsisë aktive në kontributin dhe përfitimet e rritjes ekonomike.

Rritja ekonomike në një terren të dominuar nga deficitet e lartë bilancit të pagesave, deficitet tregtar dhe varësia nga importet ushqimore, nuk konsiderohet e qëndrueshme dhe efikase. Ne e

kuptojmë se kjo situatë nuk është e mjaftueshme. Shqetësuese mbeten ngritja e cilësisë së prodhimeve , brishtësia dhe mungesa e përvojes së bizneseve etj., si dhe evazoni fiskal e informaliteti i lartë.

Në përgatitjen e politikave ekonomike, do të fokusohemi në zhvillimin, zgjerimin dhe konsolidimin e biznesit, jo thjesht në përmirësimin e klimës së tij. Do të mbështesim pa rezerva zhvillimin e biznesit të vogël e të mesëm, duke modifikuar reformat ligjore për reduktimin e barrierave dhe barren administrative si dhe kostove të berjes biznes. Synimi ynë është reduktimi i informalitetit, evazionit fiskal dhe eliminimi i korrupsionit.

Do të punojmë për thellimin e lirisë së tregut, garantimin e konkurrencës së ndershme dhe parandalimin e monopoleve tregtare. Plani ynë përfshin heqjen e taksave për biznesin e vogël dhe reduktimin e barrës fiskale brenda mandatit qeverisës. Gjithashtu, do të rrisim efikasitetin e shërbimeve të administratës publike, duke krijuar një partneritet të qëndrueshëm shtet-biznes.

Politikat tona do të harmonizohen plotësisht me standardet e BE dhe politikat ekonomike evropiane për ndërmarrjet e vogla e të mesme, me theks të veçantë në rritjen e konkurrueshmërisë dhe punësimin. Do të nxisim kulturën moderne të të bërit biznes, duke u fokusuar në përmirësimin e menaxhimit, kualifikimin e punonjësve, standardet e larta të cilësisë, thithjen e investimeve të jashtme dhe thellimin e inovacioneve.

## **Partneriteti publik-privat**

**Konteksti, Sfidat, Mundësitë – Partneriteti Publiko-Privat (PPP)** është një marrëveshje kontraktuale ndërmjet sektorit publik dhe atij privat për ofrimin e një aktiviteti apo shërbimi publik. Në nivel global, PPP-të janë shfrytëzuar si një mjet efektiv për zhvillimin e infrastrukturës dhe promovimin e investimeve në sektorë të

ndryshëm, si transporti, infrastruktura energjetike, turizmi, minierat, arsimit apo shëndetësia, duke kontribuar në rritjen ekonomike të vendeve dhe mirëqenien e komunitetit.

Partneriteti publik-privat vlerësohet si një marrëdhënie efikase bashkëpunimi ndërmjet dy sektorëve: institucioneve publike dhe atyre private. Ky model bashkëpunimi, në shtete të ndryshme të zhvilluara apo në zhvillim të shpejtë, ka dhënë rezultate shumë pozitive në zhvillimin dhe rritjen e ekonomisë.

Partneriteti publik-privat nuk konsiderohet si privatizim, shitje, kalim i pronësisë apo ndonjë formë tjetër e kësaj natyre. Përkundrazi, ai shihet si bashkëpunim dhe koordinim i aktiviteteve në fushën e biznesit ndërmjet dy sektorëve, me qëllim investimin në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, në infrastrukturë, energji, mjedis dhe shërbime publike.

### **Masat dhe Veprimet:**

- Do të punojmë që shteti dhe sektori privat të ndërgjegjësohen maksimalisht për nxitjen dhe zgjerimin e kësaj platforme të re ekonomike.
- Do ta konsiderojmë PPP-në si një politikë specifike dhe efikase të ambientit të afarizmit për tërheqjen e kapitalit privat dhe investimeve të huaja në ekonomi. Do të ndërmarrim masa dhe politika specifike për një promovim sa më të plotë të PPP-së në Kosovë.

## **Punësimi - Forcimi i kapitalit Njerëzor**

**Konteksti, Sfidat, Mundësitë – Të dhënat statistikore**

vërtetojnë treguesin e pakundërshtueshëm se në Kosovë ka normë të lartë të papunësisë. Kjo papunësi prek kryesisht të rinjtë dhe femrat, që mund të bëhen shkak për trazira dhe pakënaqësi sociale, dhe për migrimin e kapitalit njerëzor – veçanërisht fuqisë punëtore të moshës 20 deri 45 vjeç. Kjo situatë bëhet edhe më shqetësuese duke ditur se më shumë se gjysma e popullsisë është nën moshën 25-vjeçare dhe rreth 21% e tyre janë të moshës 15 deri 25 vjeç.



Do ta ndryshojmë dhe zvogëlojmë gradualisht këtë shkallë papunësie, përmes rritjes së investimeve në sektoret prioritar dhe prodhues, duke transformuar strukturën e ekonomisë nga një ekonomi e bazuar në konsumin e mallrave të importuara, emigracionin dhe informalitetin, në një ekonomi që mbështetet në punë dhe shërbime produktive. Kosova vazhdon të vuajë nga një sistem arsimor i cili, në të gjitha nivelet, dështon në adresimin e nevojave pedagogjike dhe aftësimin e nxënësve për kërkesat e ekonomisë.



### Masat dhe Veprimet:

- o Do të zhvillojmë reforma dhe do të orientojmë tërësisht nivelin e arsimit profesional drejt nevojave reale të tregut, duke e kthyer shtetin në financuesin dhe mbështetësin kryesor të aftësimin profesional. Sistemi mbi të cilin kjo reformë do të bazohet është sistemi evropian, konkretisht ai gjerman, që karakterizohet nga një kombinim i mësimin teorik me punën praktike.
- Do të angazhohemi gjithashtu në organizimin e kurseve me përgatitje profesionale edhe në zonat rurale për t'i dhënë nxitjen e nevojshme industrisë agro-përpunuese dhe zhvillimeve bujqësore.
- Do të përgatitim programe dhe projekte konkrete për trajnimin e të gjithë punëkërkuessve të regjistruar nëpër zyrat e punësimit në komuna, duke përfshirë të gjithë të rinjtë, gratë dhe vajzat e regjistruara si punëkërkuess brenda një viti.
- Në bashkëpunim me sektorin privat, në partneritete publike-

private, do të krijojmë degë në arsimin e lartë profesional të bazuara në kërkesat dhe nevojat e tregut të punës.

- Do të themelojmë pranë zyrës së Kryeministrit një Departament apo Agjenci Kombëtare të Punësimit, si një njësi buxhetore me buxhet dhe administrim të plotë, e cila do të mbledhë informata për punëkërkuessit dhe do të zhvillohet sipas praktikave më të mira, duke modernizuar zyrat e punës, sistemin e sigurimeve të punësimit, programin e nxitjes së punësimit dhe trajnimet profesionale, si dhe duke koordinuar aktivitetet me të gjitha komunat dhe sektorin privat.
- Do të zhvillojmë aktivitetin e dialogut të munguar deri më tani me sindikatat për të rikthyer kulturën trepaleshe mes shtetit, punëdhënësve e punëmarrësve, çka do të detyrojë edhe Agjencinë e Punës si një instrument themelor në hartimin e politikave të punësimit, pagave e përfitimeve sociale.
- Do të angazhohemi të përgjysmojmë papunësinë e regjistruar femërore dhe të rrisim aksesin e personave me aftësi të kufizuara në punësim përmes programeve dhe kurseve kualifikuese të përshtatura për ta.
- Do të zgjerojmë shërbimin arsimor dhe formimin profesional në fshat, duke ofruar aftësi në bujqësi, agropërpunim e shërbime bujqësore.
- Do të krijojmë programe dhe kurse kualifikuese të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara, etj.

## **Energjia**

**Konteksti, Sfidat, Mundësitë** – Nevojat për energji elektrike në Kosovë janë në rritje të vazhdueshme, ndërsa strategjia energjetike e vendit nuk ka arritur ta adresojë as problemet aktuale, e aq më pak nevojat e së ardhmes. Shumë projekte të planifikuara energjetike

kanë mbetur të porealizuara. Refuzimi i gazsjellësit amerikan, mungesa e investimeve në kapacitete të reja, revitalizimi i pamjaftueshëm i KEK-ut, si dhe shkalla e ulët e ndërtimit të kapaciteteve të energjisë së ripërtëritshme, e kanë bërë Kosovën të varur nga importi i energjisë.

Furnizimi i energjisë elektrike në Kosovë mbetet problematik, pavarësisht investimeve të mëdha dhe burimeve natyrore të pasura për prodhim. KEK-u aktualisht përballet me sfida të shumta në menaxhim, teknologji, operacione, tregti dhe financa. Këto probleme jo vetëm që rrezikojnë zhvillimin dhe funksionimin normal të KEK-ut, por pengojnë edhe integrimin e tij në sistemet rajonale të energjisë dhe investimet e reja. Si pasojë, sektori i energjisë është kthyer në një pengesë serioze për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të Kosovës.

Gjendja aktuale e keqmenaxhimit të sektorit energjetik karakterizohet nga mungesa e një plani strategjik zhvillimi dhe reformave urgjente. Ekziston një shpërputhje e konsiderueshme mes kërkesës për energji dhe ofertës së prodhimit, pavarësisht burimeve të shumta natyrore të vendit. Humbjet e larta teknike dhe jo-teknike të energjisë elektrike, si dhe mungesa e investimeve në ndërtimin e termocentraleve të reja me kapacitet të lartë prodhues, e rëndojnë më tej situatën.

Ndërprerjet e shpeshta dhe të pajustificuara të furnizimit me energji elektrike, mungesa e anëtarësimit në Tregun Rajonal të Energjisë, si dhe kaosi juridik e financiar që shoqëron KEK-un, e kanë sjellë sektorin e energjisë në prag të kolapsit financiar. Për më tepër, konsumatorët përballen me çmime të larta për njësi kilovat-orë, duke rënduar edhe më tej situatën ekonomike të vendit.





### **Masat dhe Veprimet:**

- Ndërtimi i Termocentralit të ri me kapacitet prodhues deri në 500MW.
- Ndërtimi i rrjetit të gazit.
- Energji efikase, që ofron furnizim të vazhdueshëm, të stabilizuar dhe me çmim të përballueshëm.
- Ulja e TVSH-së së energjisë elektrike në nivelin 6% për përdoruesit familjarë.
- Reformimi i metodave të përcaktimit të tarifave për njësi.
- Energji elektrike me tarifë të reduktuar për familjet e Dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës së UÇK-së, si dhe familjeve të varfra në nevojë dhe me të ardhura të pakta.
- Në punë ekipore me ekspertë ndërkombëtarë e vendorë do të ndërtojmë dhe zbatojmë një Plan strategjik afatgjatë dhe efikas për KEK-un në Kosovë. Qëllimi është krijimi i një sistemi zhvillimor të qëndrueshëm operacionalisht, teknikisht dhe financiarisht, të aftë për të plotësuar kërkesën në rritje për

energji elektrike brenda vendit, duke e shndërruar Kosovën nga vend importues në vend eksportues të energjisë elektrike.

- Rritja e efikasitetit në përdorimin e energjisë elektrike në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, shërbime dhe përdorim individual, si dhe ulja e humbjeve teknike.
- Integrimi i KEK-ut me Sistemet Rajonale dhe Evropiane të energjisë elektrike, si dhe rritja e bashkëpunimit midis dy sistemeve elektroenergjetike Kosovë-Shqipëri, duke mundësuar shfrytëzimin me efikasitet të lartë të burimeve energjetike të të dy vendeve.
- Reforma në dispozitat ligjore dhe strukturore në KEK dhe në tregun e energjisë elektrike, duke plotësuar kushtet për liberalizimin e shitjes së energjisë elektrike në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.
- Rritja e pavarësisë së Zyrës Rregullatore të Energjisë (ZRRE), duke garantuar ushtrimin e kompetencave të këtij institucioni në mënyrë të paanshme dhe transparente.
- Monitorim i plotë i veprimtarisë së sektorit të prodhimit të energjisë elektrike dhe i investimeve për ndërtimin e burimeve të reja prodhuese të energjisë elektrike.
- Krijimi i ambientit të favorshëm ekonomiko-ligjor që siguron një zhvillim të hovshëm e të qëndrueshëm të këtij sektori si superfuqi e zhvillimit ekonomik. Kjo do të përfshihet në kuadrin e ekonomisë së energjisë dhe përdorimit efikas të saj në ekonomi dhe në konsum familjar.
- Do të kujdesemi për unifikimin sa më të mirë të zhvillimit dhe të investimeve në sektorin energjetik me ruajtjen e mjedisit dhe burimeve natyrore.
- Investime në rrjetin e transmetimit që sigurojnë edhe lidhje të mjaftueshme me sistemin energjetik të Evropës Juglindore.

# Industria e Ushqimit dhe Bujqësia

**Konteksti, Sfidat, Mundësitë** – Bujqësia është një sektor strategjik dhe tradicional për Kosovën. Programi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës synon që përmes investimeve të fuqishme në bujqësi dhe industrinë e ushqimit të rrisë kapacitetet prodhuese dhe të përmirësojë sigurinë ushqimore në vend. Struktura e pronësisë ku dominon prona e vogël familjare është pengesë e shfrytëzimit racional të potencialit të tokës e përcjellë me mungesë të infrastrukturës ekonomike, depopullim të zonave rurale dhe moshë e pronarëve aktual, pajisjet e vjetruara dhe mungesa e politikave adekuate, janë pengesat për kontributin e bujqësisë në zhvillim dhe punësim.

## **Masat dhe Veprimet:**

- Përshtatja e politikave bujqësore dhe shfrytëzimi më i mirë i burimeve për prodhim bujqësor dhe ushqimor.
- Trefishimi i financimit publik për mbështetjen e bujqësisë, duke përfshirë:
  - o Rritjen e subvencioneve financiare;
  - o Sigurimin e formave shtesë të financimit (kredi të buta, etj.);
  - o Subvencionimin e kostos së garancive bankare për sektorin e bujqësisë dhe përpunimit të ushqimit.
- Konsolidimi i pronave përmes programit gjithëpërfshirës dhe rregullimi i kadastrave, duke përfshirë:
  - o Regjistrimin e pasurive në zonat rurale dhe zgjidhjen e problemeve të pronësisë;

- o Ndryshimin e Ligjit për trashëgimin, ku toka t'u jepet atyre që e punojnë dhe jetojnë prej saj;
  - o Krijimin e fondeve stimuluese për blerjen e tokës nga familjet e moshuara dhe jobujqësore.
- Investime në infrastrukturën bujqësore:
- o Krijimi i fondit për modernizimin e infrastrukturës bujqësore;
  - o Investime mbi 100 milionë € për sistemin e ujitjes së tokave bujqësore;
  - o Ndërtimi i liqeneve akumuluese për sigurimin e ujit të nevojshëm për bujqësi dhe amvisëri.



- Ristrukturimi i njësive agro-ekonomike dhe rritja e aftësive të tyre konkurruese:
- o Krijimi i një klime të qëndrueshme për investime në bujqësi, veçanërisht të IHD;
  - o Zhvillimi i skemës së subvencionit të prodhimit sekondar;
  - o Investim në përmirësimin dhe standardizimin e cilësisë

së produkteve ushqimore.

- Reduktimi i taksave për fermerët dhe bujqësinë:
  - o Zbatimi i një pakete të re reduktimi taksash për produktet bujqësore dhe investimet në fermat e vogla dhe të mesme;
  - o Heqja e tatimit në fitim për katër vitet e para për industrinë e reja agropërpunuese;
  - o Lehtësi fiskale në kostot e ambalazhimit dhe paketimit.
- Programi i trajnimeve dhe edukimit për fermerët:
  - o Implementimi i një programi të gjerë trajnimesh mbi teknikat moderne të kultivimit, menaxhimit dhe financave dhe strategjitë e shitjes;
  - o Angazhim për orientimin e qytetarëve drejt rritjes së kapaciteteve kadrovike në sektorin e prodhimit të ushqimit.
- Zhvillimi i politikave që kanë në qendër të vëmendjes familjet që merren me bujqësi, blegtori, pentari dhe aktivitete të tjera rurale.
- Angazhim në eliminimin e barrierave jotarifore që vendosen nga vendet rajonale ndaj prodhimeve tona ushqimore.
- Integrimi i prodhimit bujqësor me Kosovën për krijimin e një tregu të përbashkët bujqësor e ushqimor.
- Programi "Eksploro Fermerin" për zhvillimin e turizmit rural.
- Hartimi i një plani zhvillimor për garantimin e transparencës në planifikimin dhe zhvillimin rajonal.

- Decentralizimi dhe mbështetja e pushtetit vendor në zhvillimin e tokës dhe mbrojtjen e zonave natyrore, historike dhe bujqësore.
- Veprime legjislativë dhe teknike për pengimin e degradimit të mëtejshëm të tokës dhe zhvillimin e tregut të tokës.
- Projektimi dhe përcaktimi i politikave me specifika ndërtimore, arkitekturore dhe urbanistike tradicionale të zonave dhe fshatrave.
- Përfundimi i ekonomisë informale në zhvillimin e tokës dhe hapësirave urbane e rurale.

## **Spektori i Turizmit**

**Konteksti, Sfidat, Mundësitë** – Pasuritë natyrore të Kosovës paraqesin burim të cilësisë së lartë për turizëm. Përshkrimi i potencialit turistik të Kosovës lidhet ngushtë me pozitën e saj gjeografike. Vendndodhja e Kosovës në Evropën Juglindore, me pozitë qendrore në Gadishullin Ballkanik, përfaqëson një udhëkryq që historikisht daton që nga koha e Ilirëve dhe Romakëve.

Jugu malor i Kosovës ka potencial të madh për turizmin dimëror. Një nga mundësitë më tërheqëse është Qendra e Skijimit në Brezovicë, në malet e Sharrit. Ky resurs gjendet mes 1.700 dhe 2.500 m lartësi mbidetare. Ai ofron kushte të shkëlqyera të motit dhe borës, si dhe sezon skijimi nga nëntori deri në maj.

Disa nga vendet turistike në Kosovë janë:

Komplekset malore: Malet e Sharrit, Bjeshkët e Nemuna ku dallohen Brezovica e Rugova dhe Bjeshkët e Deçanit, si qendra skijimi dhe rekreacioni, Maja e Luboteni, Maja e Gjeravicës e cila njihet si maja më e lartë në Kosovë që arrin lartësinë mbidetare prej 2.656 metrash, etj.

Qendrat muze: Prizreni, Gjakova, Rahoveci, Dragashi, Juniku etj. kanë objekte të ndryshme me arkitekturë të rrallë nga epoka të ndryshme kohore, duke pasqyruar kultura nga civilizime të larmishme. Për më tepër, Kosova ka potencial për zhvillimin e turizmit kulturor me vende të ndryshme fetare me vlerë të jashtëzakonshme kulturore dhe historike.

Bukuritë natyrore: Bifurkacioni i Nerodimes, Ujëvara e Mirushës, Burimi i Drinit, Shpella e Gadimës, etj.

Burime termale: Banja e Kllokotit, Banja e Pejës, hotele, restorante, pishina pranë rrugëve magjistrale etj.

Janë të njohura burimet e famshme të maleve të Kosovës për shkak të efekteve të tyre shëruese. Në këtë fushë, investitorët e huaj do të gjejnë një kërkesë të lartë në tregun rajonal dhe atë të brendshëm.

Përveç resurseve turistike të përmendura më lart, Kosova është kryesisht e pasur me male, liqene artificiale dhe lumenj, gjë që ofron mundësi të mira për gjueti dhe peshkim.

Duke u bazuar në këto pasuri, turizmi është një sektor me prioritet në zhvillimin e ekonomisë së Kosovës, rritjen e prodhimit dhe zbutjen e varfërisë. Zhvillimi i turizmit do të jetë pjesë e programit të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, me potencial të madh rritjeje të integruar dhe plotësuese ndërsektoriale, që menaxhon burimet në mënyrë të balancuar, gjeneron zhvillim ekonomik dhe garanton punësim.



### **Masat dhe Veprimet:**

- Ne do të vendosim Kosovën si një destinacion të preferuar me një ofertë ekonomike turistike tërheqëse, duke krijuar një imazh të ri për Kosovën turistike, duke shfrytëzuar potencialet dhe burimet vendore, duke u fokusuar në atë çka është unike në Kosovë dhe duke ofruar shërbime në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- Synohet krijimi i një modeli turizmi vjetor të integruar, aktiv dhe social, me fokus të veçantë në turizmin kulturor-natyror-ekologjik.
- Do të hartohet dhe zbatohet Strategjia e Turizmit, në përputhje me strategjinë e zhvillimit dhe Planin e Zhvillimit Rajonal.
- Do të realizohet në mënyrë të pandërprerë një fushatë informuese dhe promovuese për imazhin e Kosovës turistike. Rol të rëndësishëm do të kenë jo vetëm institucionet publike, por edhe operatorët e industrisë së turizmit dhe të gjithë agentët e zhvillimit në vend, përfshirë median, shoqërinë civile, si dhe sistemin e shërbimit diplomatik.
- Do të krijohet baza e integruar e informacionit për turizmin,



përfshirë operatorët dhe strukturat turistike. Gjithashtu, do të ndërmerret një reformë fiskale që synon reduktimin e TVSH-së për operatorët turistikë.

- Do të krijohet një paketë e veçantë turistike Kosovë - Shqipëri - Rajon, si bashkëpunim mes vendeve me popullsi shqiptare dhe fqinjëve në rajon, me qëllim kontributin në zhvillimin ekonomik të integruar.
- Përmes planifikimit rajonal, do të realizohen programe të rëndësishme për Turizmin në Kosovë, programe nga veriu në jug. Për këto programe, në përputhje me Planin e Zhvillimit Rajonal, do të hartohen vizione zhvillimi dhe plane të investimeve kapitale. Do të krijohen dhe gjenerohen vende të reja pune në sektorin e turizmit.
- Në përputhje me modelin e Turizmit në Kosovë, do të krijohen tre programe kyçe:
  - o Programi për Turizmin Kulturor-Historik, që fokusohet në zonat e mbrojtura dhe monumentet e kulturës; promovon traditat kosovare; adreson veçanërisht turizmin e bazuar në ekonomitë familjare dhe biznesin e vogël, në bashkëpunim me operatorët e turizmit.
  - o Programi për Ekologjinë e Turizmit që ndërton mbi burimet natyrore, përdorimin ekologjik të tyre dhe pajisjen me infrastruktura e shërbime bazike, sigurinë e lartë dhe guida të përsosura profesionalisht.
  - o Programi për Turizmin Malor, i cili shoqërohet me projekte madhore të investimeve kapitale për infrastrukturë dhe shërbime, veçanërisht afër qendrave të banuara dhe përmes praktikave të partneritetit publik-privat.

# Infrastruktura

**Konteksti, Sfidat, Mundësitë** – Infrastruktura është një komponent thelbësor për zhvillimin ekonomik dhe social të çdo vendi. Në Kosovë, infrastruktura moderne është çelësi për përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve, rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë dhe forcimin e lidhjeve me vendet e tjera. Ndërsa disa projekte infrastrukturore të filluara nga qeveritë paraprake kanë mbetur të papërfunduara, është thelbësore të rifokusojmë përpjekjet tona në përmirësimin dhe zgjerimin e rrjeteve infrastrukturore në të gjithë vendin.

Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës rrugore përmes finalizimit të projekteve të filluara para këtij mandati qeverisës dhe realizimit të projekteve të reja do të kontribuojë në rritjen ekonomike dhe zhvillimin shoqëror e ekonomik. Rrugët moderne do të lehtësojnë lidhjet tregtare dhe ekonomike me vendet fqinje dhe vendet anëtare të BE-së, si dhe midis qyteteve kryesore në Kosovë, duke krijuar kushte më të mira për lëvizjen e njerëzve dhe mallrave.



## Masat dhe veprimet:

- Zhvillimi i një Plani Master për lidhje në rrjetet e gazit në rajon dhe shtrirja e infrastrukturës së gazit në të paku shtatë qendrat e Kosovës.

- Rehabilitimi dhe renovimi i linjave që ndërlidhen me rrjete rajonale e ndërkombëtare.
- Ndërtimi ose adaptimi dhe transformimi i linjës hekurudhore: Aeroporti Adem Jashari - Prishtinë.
- Ndërtimi i hekurudhës që lidh Kosovën me Shqipërinë, duke i mundësuar Kosovës qasje më të mirë në portet shqiptare.
- Rehabilitimi dhe modernizimi i linjave hekurudhore kryesore:
  - o Fushë Kosovë – Mitrovicë
  - o Fushë Kosovë - Ferizaj - Hani i Elezit
  - o Prishtinë – Pejë
  - o Pejë - Klinë – Prizren
  - o Mitrovicë – Leposaviq
- Përfundimi i infrastrukturës rrugore do të përfshijë këto akse rrugore:
  - o Autostrada e Dukagjinit
  - o Përfundimi i segmentit Prishtinë-Merdare
  - o Përfundimi i autostradës së Gjilanit
  - o Përfundimi i rrugës Dollc-Gjakovë
  - o Përfundimi i rrugës Prishtinë-Mitrovicë
  - o Përfundimi i rrugës Prishtinë-Podujevë
  - o Përfundimi i rrugës Gjilan-Konqul
  - o Përfundimi i rrugës Kijevë-Zahaq-Prishtinë-Pejë
  - o Përfundimi i rrugës Deçan-Plavë

- o Përfundimi i rrugës Komoran-Drenas-Skenderaj
- Ndërtimi i shumë rrugëve lokale në bashkëfinancim me komunat.

## Mjedisi

**Konteksti, Sfidat, Mundësitë** – Kosova sot përballet me sfida të shumta mjedisore, përfshirë ndotjen e ajrit, kontaminimin e ujit, menaxhimin e papërshtatshëm të mbeturinave dhe degradimin e lumenjve. Këto probleme e kanë shndërruar vendin në një ambient të pashëndetshëm për jetesë. Angazhimi ynë është të krijojmë një mjedis të shëndetshëm për qytetarët, duke e mbrojtur atë nga ndotja dhe dëmtimi që vijnë nga aktiviteti njerëzor dhe veprimtaritë ekonomike. Synimi ynë është ta trajtojmë mjedisin si vlerë të shtuar dhe pasuri për gjenerim të aktiviteteve ekonomike, veçanërisht atyre turistike, si dhe ta ruajmë atë si trashëgimi për brezat e ardhshëm.

Gjuetia e paligjshme dhe shfrytëzimi i pakontrolluar i natyrës, veçanërisht i parqeve kombëtare, kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme. Ne do të angazhohemi për përmirësimin e situatës aktuale duke vendosur masa rigoroze për ruajtjen e zonave të mbrojtura, duke kontrolluar rreptësisht gjuetinë dhe duke ndaluar përdorimin e armëve të gjuetisë nga persona të paautorizuar.

Kosova është e pasur me burime ujore, por është thelbësore të ndërtohet një qasje e re në menaxhimin e integruar të tyre. Do të realizojmë reforma dhe do të forcojmë kapacitetet për të rritur cilësinë e shërbimeve ujore ndaj publikut. Do të përgatiten plane për menaxhimin efektiv të baseneve kryesore ujore, veçanërisht të lumenjve dhe liqeneve. Një vëmendje e veçantë do t'u kushtohet burimeve ujore të dëmtuara nga aktivitetet e paligjshme ose ndotja mikrobiologjike dhe kimike.

Cilësia e ajrit është një element themelor për shëndetin publik.

Shumë zona në vend shfaqin nivele ndotjeje më të larta se normat e lejuara evropiane. Ne do të punojmë për përmirësimin e cilësisë së ajrit në të gjithë Kosovën, duke zbatuar politika dhe masa efektive për reduktimin e ndotjes.



### **Masat dhe Veprimet:**

Qytetarët në përgjithësi nuk janë të informuar mirë për situatën e ndotjes, rrezikun e saj, lidhjen ndërmjet mjedisit dhe shëndetit publik, si dhe përfitimet e një mjedisi të pastër për ekonominë dhe shoqërinë.

### **Përmirësimi i cilësisë së ajrit:**

- Shtimi i sipërfaqeve të gjelbra në zonat urbane.

- Kontrolli i emetimit të pluhurit duke aplikuar teknologji të reja monitorimi.
- Përdorimi i karburanteve konform kritereve të BE-së
- Zbatimi i standardeve të rrepta në aktivitetet ekonomike që ndotin ajrin.
- Dekompozimi i termocentralit "KOSOVA A".

- Ndalimi i përdorimit të thëngjillit si lëndë djegëse në amvisëri dhe institucione private.

- Vendosja e sistemit radarik për Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës.

#### **Menaxhimit të burimeve ujore:**

- Shtimit të rezervave ujore përmes ndërtimit të digave akumuluese.
- Ndërtimit dhe funksionalizimit të impianteve për trajtimin e ujërave të zeza.
- Mirëmbajtjes sistematike të shtretërve të lumenjve për parandalimin e vërshimeve.
- Mbrojtja e mjedisit dhe biodiversitetit:
  - o Fuqizimi i mbrojtjes së parqeve nacionale.
  - o Kalimi i menaxhimit të pronave pyjore nga Agjencioni i Pyjeve të Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit.
- Menaxhimit të mbeturinave:
  - o Reduktimi masiv i përdorimit të plastikës dhe produkteve mbështjellëse plastike.
  - o Funksionalizimi i sistemit të rikthimit të depozitave përmes kaucionit.

- o Eliminimi i qeseve të plastikës dhe zëvendësimi me qese letre.
  - o Kontrolli, mbikëqyrja dhe eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave.
  - o Mbështetja dhe licencimi i kompanive për riciklim dhe inceneratorëve sipas kushteve të BE-së.
  - o Trajtimi i mbetjeve inerte dhe atyre nga druri.
- Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional:
- o Plotësimi me ligje të reja dhe modifikimi i ligjeve aktuale për mbrojtjen e mjedisit.
  - o Fuqizimi i rolit monitorues e kontrollues të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit.
  - o Ndarja e kompetencave për autorizimet, menaxhimin dhe inspektimin.
  - o Implementimi i plotë të pullës mjedisore.
  - o Zbatimi i Udhëzimit Administrativ për matjen e emetimit të gazrave gjatë kontrollit teknik të automjeteve.
  - o Themelimi i Departamentit të Policisë Mjedisore.
  - o Krijimi i Eko-Fondit për buxhet për mjedisin
- Iniciativave të tjera:
- o Shpërblimi i komunave që zbatojnë udhëzimet mjedisore dhe krijojnë zona të gjelbra.
  - o Shtimi i numrit të inspektorëve mjedisorë.
  - o Vendosja e kamerave për identifikimin e ndotësve.



- o Zgjatja e afatit për zhdoganimin e veturave të importuara nga 10 në 15 vjet.
- o Taksa shtesë për produktet ndotëse dhe lirimin nga taksat për produktet ekologjike

## Menaxhimi i ujërave

Ne kemi hartuar një program të detajuar për infrastrukturën ujore, duke planifikuar projekte të rëndësishme për katër vitet e ardhshme. Qëllimi ynë është të ofrojmë zgjidhje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për furnizimin me ujë të pijshëm në të gjithë Kosovën.

Disa projekte janë aktualisht në fazën e studimit të fizibilitetit. Ne jemi të vendosur të mos pengojmë apo ndryshojmë destinimin e këtyre projekteve. Përkundrazi, do t'i analizojmë me profesionalizëm , duke siguruar që pas vlerësimit të thelluar, zbatimi i tyre të fillojë pa vonesa të panevojshme.

Duke njohur kompleksitetin dhe kohën e nevojshme për realizimin e veprave hidroteknike, ne angazhohemi për një qasje profesionale gjatë gjithë procesit. Megjithatë, konsiderojmë të pajustificueshme që studimet e fizibilitetit dhe dizajnet kryesore të zgjasin po aq sa ndërtimi i një pendë të madhe.

Prandaj, do të fokusohemi në përshpejtimin e fazave përgatitore, duke përfshirë miratimin e projekteve dhe sigurimin e fondeve, me qëllim që implementimi të fillojë në kohën optimale. Kjo qasje do të sigurojë realizimin efikas të projekteve të infrastrukturës ujore, duke kontribuar në përmirësimin e furnizimit me ujë në Kosovë.

### **Penda e Pollatës, Komuna e Podujevës**

Penda e Pollatës, e planifikuar të ndërtohet në komunën e

Podujevës, përbën një projekt të rëndësishëm për menaxhimin e burimeve ujore dhe përmirësimin e furnizimit me ujë për banorët e kësaj zone. Me rritjen e popullsisë dhe nevojave për ujë, ndërtimi i kësaj pende paraqet një zgjidhje efektive për sfidat që lidhen me thatësinë dhe përmirësimin e infrastrukturës ujore.

Aktualisht, projekti është në fazën e dizajnit kryesor, dhe më pas pritet të fillojë ekzekutimi i punimeve. Penda do të ketë një kapacitet akumulimi të konsiderueshëm, duke siguruar një burim të qëndrueshëm uji gjatë gjithë vitit. Dizajni do të përfshijë aspekte moderne dhe të qëndrueshme që do të kontribuojnë në efikasitetin e operimit dhe menaxhimin e burimeve ujore.

Vendbanimet kryesore që pritet të furnizohen me ujë nga kjo pendë përfshijnë Podujevën, si qytetin më të afërt, i cili do të jetë përfituesi kryesor i këtij projekti, poashtu do të garantojë një furnizim më të qëndrueshëm me ujë të pijshëm për popullsinë dhe për industrinë lokale, duke rritur cilësinë e jetesës dhe mbështetur zhvillimin ekonomik të zonës.

Ky projekt do të ndihmojë në reduktimin e mungesës së ujit gjatë sezonit të verës, kur kërkesa për ujë rritet ndjeshëm për shkak të aktiviteteve bujqësore dhe nevojave të përditshme të popullsisë.



Ndërtimi i pendës do të sjellë një sërë përfitimesh ekonomike dhe sociale. Furnizimi i qëndrueshëm me ujë do të ndihmojë në rritjen e prodhimeve bujqësore, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të rajonit. Për më tepër, krijimi i vendeve të punës gjatë fazës së ndërtimit dhe mirëmbajtjes së pendës do të ndikojë pozitivisht në ekonominë lokale.

### **Penda në Dragaçinë, Komuna e Suharekës**

Penda në Dragaçinë planifikohet të ndërtohet në komunën e Suharekës, në jugperëndim të Kosovës. Kjo zonë është përzgjedhur për shkak të kushteve hidrologjike të favorshme, të cilat ofrojnë potencialin e nevojshëm për krijimin e një rezervuari që do të ndihmojë në përmirësimin e furnizimit me ujë në rajon.

Vendbanimet kryesore që pritet të furnizohen me ujë nga kjo pendë përfshijnë Suharekën, si qytetin më të afërt, i cili do të jetë përfituesi kryesor i këtij projekti. Kjo do të garantojë një furnizim më të qëndrueshëm me ujë të pijshëm për popullsinë dhe për industrinë lokale, duke rritur cilësinë e jetesës dhe mbështetur zhvillimin ekonomik të zonës.

Po ashtu, një numër fshatrash të tjerë në komunën e Suharekës, që shpesh përballen me furnizim të pamjaftueshëm me ujë, do të përfitojnë nga ky akumulacion. Ky projekt pritet të ndihmojë në eliminimin e krizave të ujit dhe në sigurimin e një burimi të besueshëm për nevojat e përditshme të banorëve.



Po ashtu, një numër fshatrash të tjerë në komunën e Suharekës, që shpesh përballen me furnizim të pamjaftueshëm me ujë, do të përfitojnë nga ky akumulacion. Ky projekt pritet të ndihmojë në eliminimin e krizave të ujit dhe në sigurimin e një burimi të besueshëm për nevojat e përditshme të banorëve.

Sa i përket kapacitetit ujëmbledhës, penda në Dragaçinë pritet të ketë një kapacitet prej rreth 5 milionë metra kub ujë. Megjithatë, sasia e saktë e kapacitetit ujëmbledhës do të përcaktohet vetëm pas hartimit të projektit kryesor, ku do të merren parasysh faktorë të ndryshëm si terreni, klimë, dhe potenciali hidrologjik. Ky kapacitet është projektuar për të përballuar nevojat e popullsisë dhe industrisë lokale, duke siguruar furnizim të qëndrueshëm me ujë të pijshëm, si dhe për qëllime të tjera, si ujitja e tokave bujqësore dhe përdorime industriale. Ky rezervuar gjithashtu do të ndihmojë në menaxhimin më të mirë të ujërave dhe parandalimin e përmytjeve gjatë reshjeve të mëdha, duke ofruar një zgjidhje të qëndrueshme për sfidat klimatike dhe mjedisore.

Penda e Dragaçinës planifikohet të ndërtohet në rrjedhën e lumit Toplluha, që kalon nëpër komunën e Suharekës. Ky lum është një nga degët e vogla të rrjetit lumor të Kosovës, i cili ushqehet kryesisht nga burimet ujore në rajonin malor përreth, duke ofruar një

burim të qëndrueshëm për akumulimin e ujit. Prurjet mesatare të lumit Toplluha janë të ndryshueshme varësisht nga sezoni dhe reshjet, por ato pritet të jenë rreth 1 deri në 2 m<sup>3</sup>/s gjatë periudhave të reshjeve intensive. Gjatë periudhave të thata, prurjet mund të jenë dukshëm më të ulëta, por penda do të ndihmojë në rregullimin e këtyre prurjeve, duke siguruar një furnizim të qëndrueshëm me ujë, edhe në kohë të thatësirës.

Për më tepër, ndërtimi i kësaj pende do të sjellë përfitime të shumta për komunitetin lokal, duke krijuar mundësi për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe përmirësimin e kushteve të jetesës. Me këtë projekt, pritet të forcohet kapaciteti menaxhues për burimet ujore, duke garantuar një qasje më të integruar dhe të planifikuar ndaj menaxhimit të ujit, që është thelbësor për një zhvillim të qëndrueshëm në komunën e Suharekës dhe përreth.

### **Ndërtimi i digës së Kuqicës në Drenicë**

Penda Kuqicë pritet të ndërtohet në rajonin e Drenicës, afër fshatit Kuqicë në komunën e Skenderajt, në pjesën qendrore të Kosovës.

Ndërtimi i digës së Kuqicës në Drenicë është një projekt strategjik i rëndësishëm për menaxhimin e burimeve ujore dhe zhvillimin e qëndrueshëm të kësaj zone. Kjo digë do të krijojë një rezervuar që do të kontribuojë në rritjen e kapacitetit të furnizimit me ujë për banorët e Drenicës dhe për zonat përreth, duke siguruar një burim të besueshëm për ujë të pijshëm dhe ujitje për bujqësi.

Zgjedhja e vendndodhjes për ndërtimin e digës është bërë duke marrë parasysh kushtet hidrologjike të favorshme dhe potencialin për të menaxhuar më mirë ujërat sipërfaqësore.



Diga e Kuçicës do të ndihmojë në rregullimin e prurjeve të ujit, duke reduktuar rrezikun e përmytjeve gjatë periudhave me reshje të mëdha dhe duke kontribuar në ruajtjen e ekosistemit lokal.

Kapaciteti i prurjeve të ujit do të jetë i përshtatur për të përmbushur nevojat e popullsisë dhe të industrive lokale, duke u siguruar kështu një furnizim të qëndrueshëm me ujë të pijshëm. Pritet që diga të ketë një kapacitet akumulues të konsiderueshëm, i cili do të lejojë ruajtjen e ujit për periudha të thata, duke ofruar siguri për fermerët dhe komunitetet që varen nga bujqësia.

Diga e Kuçicës do të ndihmojë gjithashtu në krijimin e mundësive për zhvillim ekonomik, duke ofruar mundësi për investime në sektorin e turizmit dhe rekreacionit. Me krijimin e një rezervuari të tillë, zona do të bëhet më atraktive për vizitorët, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit rural dhe aktiviteteve në natyrë.




Figura 34 – Toka bujqësore për ujitje

Komuna	Sipërfaqja (ha)	Lartësia (m.m.n.d.)
Kamenicë	5,013	430 - 640
Ranillug	1,362	430 - 550

Tabela 39 – Toka bujqësore

## Ndërtimi i pendës në Desivojce, komuna e Kamenicës

Ky projekt ka për qëllim ndërtimin e një pendë në rrjedhën e lumit Desivojce, e cila do të ketë kapacitetin e nevojshëm për të furnizuar me ujë qytetin e Kamenicës, vendbanimin më të madh në rajon, si dhe fshatrat përreth. Ky projekt, i konsideruar strategjik, aktualisht ndodhet në fazën e studimit të fizibilitetit, që do të pasojë me faza të tjera, duke përfshirë projektimin e detajuar dhe punët ndërtimore.

Në kuadër të këtij projekti, do të shqyrtohet mundësia e

integritet të sistemeve rurale të ujit, disa prej të cilave janë tashmë të ndërtuara dhe funksionale. Një komponentë që pritet të adresohet gjatë projektimit të kësaj pende është ujitja e tokave të komunës së Kamenicës.

Megjithatë, karakteristikat e projektit, si prurjet e ujit, kapaciteti i akumulacionit, dhe madhësia e pendës që planifikohet të ndërtohet, do të përcaktohen pas përfundimit të studimit të fizibilitetit dhe hartimit të projektit kryesor. Zbatimi i suksesshëm i këtij projekti pritet të sjellë përmirësime të dukshme në besueshmërinë e furnizimit me ujë për Kamenicën dhe zonat përreth. Po ashtu, do të kontribuojë në rritjen e produktivitetit bujqësor përmes një sistemi më të efektshëm të ujitjes dhe do të ndihmojë në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të komunës.

### **Zgjidhja afatgjatë e furnizimit me ujë për komunën e Gjilanit**

Qyteti i Gjilanit dhe zonat përreth kanë qenë të prekura nga sfida të mëdha sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm që nga periudha e pasluftës. Këto sfida kanë ardhur në pah më së shumti gjatë periudhave të thatësirës, kur mungesa e burimeve të qëndrueshme të ujit ka sjellë vështirësi serioze për popullsinë dhe ekonominë lokale. Veçanërisht, vitet 2013 dhe 2019 kanë qenë shenjdhënëse për krizën e thellë që mund të shkaktojë mungesa e ujit, duke i shtyrë autoritetet lokale dhe kombëtare të ndërmarrin masa emergjente për të siguruar furnizimin e përkohshëm me ujë. Këto periudha kritike kanë treguar qartë dobësitë e sistemit ekzistues të furnizimit, i cili është i varur nga burime të kufizuara dhe infrastrukturë e vjetruar.

Sipas raporteve të institucioneve të ndryshme, është vërtetuar se rajoni i Gjilanit është i vetmi rajon në Kosovë që ka mungesa të theksuara të burimeve ujore. Këto raporte kanë dokumentuar se shkalla e disponueshmërisë së ujit për frymë është ndjeshëm më e ulët në krahasim me rajonet e tjera të Kosovës, duke e bërë Gjilanin



të ndjejë presion të vazhdueshëm nga rritja e popullsisë dhe kërkesat gjithnjë e në rritje për ujë. Një studim i vitit 2022 nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit ka konfirmuar se ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe menaxhimi i pamjaftueshëm i burimeve ujore kontribuojnë në këtë situatë alarmante.

Përballë rritjes së popullsisë dhe ndryshimeve klimatike që rrisin rrezikun e periudhave të thata, është bërë e qartë që qyteti i Gjilanit ka nevojë për një zgjidhje afatgjatë dhe të qëndrueshme për furnizimin me ujë. Kjo zgjidhje duhet të jetë e bazuar në një strategji gjithëpërfshirëse që merr parasysh burimet e reja të ujit, modernizimin e infrastrukturës ekzistuese dhe menaxhimin më të mirë të burimeve për të shmangur krizat e ardhshme.

### **Problematika aktuale**

- **Kapacitet i pamjaftueshëm i burimeve ujore:** Burimet e tanishme nuk janë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesën gjithnjë e në rritje të qytetit dhe zonave rurale përreth. Periudhat e thatësirës, si ato të viteve 2013 dhe 2019, kanë zbuluar që sistemi aktual është i paqëndrueshëm dhe i pafuqishëm për të përballuar ngarkesat e pikut të konsumit, duke çuar në kufizime të rrepta në furnizim.
- **Infrastruktura e vjetruar:** Një pjesë e madhe e rrjetit të furnizimit me ujë është e dëmtuar dhe e vjetruar, duke shkaktuar humbje të konsiderueshme të ujit. Tubacionet e rrënuara dhe mungesa e mirëmbajtjes së duhur kanë çuar në uljen e eficiencës së rrjetit, duke e bërë furnizimin më të vështirë gjatë periudhave kritike.
- **Shpërndarje e pabarabartë e ujit:** Për shkak të menaxhimit jo të duhur të presionit të ujit, disa zona të qytetit dhe fshatrat përreth përballen me mungesë të ujit ose presion të ulët, duke krijuar një situatë të pabarabartë në furnizimin me ujë.

## Zgjidhjet e propozuara

Për të adresuar mungesën e burimeve ujore dhe për të rritur kapacitetin e furnizimit gjatë periudhave të pikut, janë propozuar tri opsione të projekteve kryesore për ndërtimin e pendave:

- **Ndërtimi i pendës në rrjedhën e lumit Morava e Binqës tek Shusht, Viti**

Ndërtimi i pendës në rrjedhën e lumit Morava e Binqës në Shushicë, Viti, është një projekt i rëndësishëm për furnizim me ujë të qytetit të Gjilanit, Vitis dhe zonave përreth. Ky projekt do të krijojë një burim të qëndrueshëm të ujit, duke u përqendruar në rritjen e kapacitetit për t'u përballur me periudhat e konsumit të lartë, siç janë verërat e thata.



Penda do të ndihmojë në menaxhimin e resurseve ujore dhe do të lejojë ruajtjen e ujit për periudha të ndryshme klimatike, duke garantuar furnizim të vazhdueshëm për nevojat e popullsisë dhe sektorëve ekonomikë. Kjo do të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e jetesës për banorët e komunës së Gjilanit dhe Vitis si dhe do të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm të aktiviteteve bujqësore dhe industriale.

Përveç kësaj, ndërtimi i pendës do të kontribuojë në ruajtjen e ekosistemeve përreth, duke krijuar një ambient më të favorshëm për biodiversitetin. Ky projekt gjithashtu do të krijojë mundësi për zhvillimin e aktiviteteve turistike, duke ofruar mundësi për rekreacion dhe njohje me natyrën.

Për të siguruar suksesin e këtij projekti, do të kërkohet një planifikim i detajuar dhe një bashkëpunim i ngushtë me autoritetet lokale dhe të komunitetit, për të garantuar qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e burimeve ujore për të ardhmen.

**- Ndërtimi i pendës në rrjedhën e lumit Llapushnica pranë fshatit Pogragjë:**

Ndërtimi i pendës në rrjedhën e lumit Llapushnica pranë fshatit Pogragjë përfaqëson një investim strategjik për përmirësimin e burimeve ujore në rajonin e Gjilanit dhe zonat rurale përreth. Kjo pendë do të krijojë një burim alternativ të rëndësishëm të ujit, duke plotësuar nevojat e qytetit dhe fshatrave përreth, veçanërisht gjatë periudhave kritike të thatësisë, kur rezervat ekzistuese mund të mos jenë të mjaftueshme për të përballuar kërkesën në rritje.

Ky projekt ka për qëllim jo vetëm të sigurojë një furnizim më të qëndrueshëm të ujit për popullsinë e zonës, por gjithashtu të përmirësojë kapacitetet e menaxhimit të ujit gjatë periudhave të vështira klimatike. Në rastet e verërave të gjata dhe të thata, ku thatësira ndikon negativisht në burimet ekzistuese, kjo pendë do të veprojë si një rezervuar kyç, duke garantuar që nevojat për ujë të përmbushen, si për konsum human ashtu edhe për përdorim



Një aspekt tjetër i rëndësishëm është ndikimi pozitiv në zhvillimin ekonomik të zonës, pasi një furnizim më i qëndrueshëm me ujë do të mbështesë zhvillimin e sektorëve si bujqësia, që shpesh vuan më shumë nga mungesa e ujit gjatë periudhave të thata. Po ashtu, penda do të krijojë mundësi të reja për aktivitete rekreative dhe turistike, duke përmirësuar cilësinë e jetesës dhe zhvillimin ekonomik të komunitetit lokal.

**- Ndërtimi i pendës në rrjedhën e lumit Lepenc pranë fshatit Firajë, Komuna e Shtërpçës (Projekti i Lepencit):**

Është një iniciativë e rëndësishme që i shërben strategjisë rajonale të menaxhimit të burimeve ujore. Ky projekt është planifikuar për të kontribuar në furnizimin e qëndrueshëm me ujë për zonat jugore të Kosovës, përfshirë qytetet si Gjilan, Ferizaj, Shtërpçë, Viti, dhe zonat përreth.

Sipas raportit të publikuar nga Ministria e Infrastrukturës, ky projekt synon të sigurojë një burim alternativ dhe të qëndrueshëm të ujit për rreth 150,000 banorë në këto zona. Një burim me kapacitet të madh do të ndihmojë në plotësimin e kërkesave në rritje për ujë, sidomos gjatë periudhave të konsumit të lartë, siç janë verërat e thata. Analizat e kryera nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës tregojnë se burimet ekzistuese shpesh janë të ngarkuara, duke sjellë probleme të furnizimit për qytetarët dhe sektorët ekonomikë.



Penda e planifikuar do të ndihmojë në ruajtjen e ekosistemit lokal dhe në parandalimin e ndotjes së burimeve ujore. Një studim i fundit nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë thekson se menaxhimi i qëndrueshëm i ujit është thelbësor për ruajtjen e biodiversitetit dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës për banorët e rajonit.

### **Evakuimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura në Kosovë**

Ne i kushtojmë rëndësi të veçantë evakuimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në të gjithë Kosovën. Aktualisht, disa qytete të mëdha si Prizreni, Peja dhe Gjakova kanë impiante për trajtimin e ujërave të ndotura, ndërsa në Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj dhe Prishtinë, projektet janë në fazat e para të ndërtimit. Megjithatë, është vërejtur

neglizhencë në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e këtyre projekteve.

Gjatë mandatit tonë, angazhohemi të ndjekim me përpikëri këto projekte dhe të marrim masa konkrete për përshejtimin e tyre. Duke qenë se këto projekte lidhen drejtpërdrejt me mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin publik, do të vendosim një mekanizëm monitorimi efektiv dhe do të bashkëpunojmë ngushtë me autoritetet lokale dhe ndërkombëtare për të garantuar realizimin e tyre brenda afateve.

Gjithashtu, do të fokusohemi në ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura në komunat më të vogla, të cilat nuk mund të përfshihen në impiantet qendrore rajonale. Synojmë të ndërtojmë impiante të përmasave të vogla ose të mesme që i përgjigjen kërkesave specifike të këtyre komunave.

Ky angazhim është thelbësor për një qasje gjithëpërfshirëse në menaxhimin e ujërave të ndotura në nivel kombëtar. Përmes këtij plani, synojmë të mbështesim edhe komunat rurale në zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme, duke ofruar një zgjidhje të qëndrueshme për përmirësimin e shërbimeve sanitare në të gjithë vendin. Këto veprime do të kenë ndikim pozitiv në ruajtjen e mjedisit dhe do të përmirësojnë kushtet e jetesës dhe shëndetin e të gjithë qytetarëve të Kosovës.

## **Menaxhimi i ujërave atmosferike në Kosovë dhe ripërdorimi i tyre**

Menaxhimi i ujërave atmosferike është një sfidë kryesore për planifikimin urban dhe mbrojtjen e burimeve natyrore në Kosovë. Me rritjen e shpejtë të urbanizimit, ndryshimet klimatike dhe periudhat e shpeshta të shirave të mëdha, nevoja për një sistem të avancuar të menaxhimit të ujërave atmosferike është bërë më kritike se kurrë. Këto ujëra, që përfshijnë reshjet e shiut dhe të borës, shpesh shndërrohen në burim përmbytjesh urbane dhe ndotjeje mjedisore nëse nuk menaxhohen siç duhet.

Vjelja dhe ripërdorimi i ujërave atmosferike paraqet një qasje të qëndrueshme për trajtimin e këtyre problemeve. Kjo metodë përfshin mbledhjen e ujit të shiut nga sipërfaqe të ndryshme si çatitë e ndërtesave dhe hapësirat urbane të pashfrytëzuara, trajtimin e tij për të hequr ndotësit, dhe përdorimin për qëllime jo të pijshme. Ripërdorimi i ujit të shiut është veçanërisht i vlefshëm për ujitje në sektorin bujqësor, përdorim në industrinë që kërkojnë ujë teknik, dhe për aplikime të tjera urbane si pastrimi i rrugëve dhe rezervuarët për emergjenca.



Përfitimet kryesore të kësaj qasjeje përfshijnë:

- Uljen e rrezikut të përmbytjeve urbane: Përmes zgjidhjeve të bazuara në natyrë, si krijimi i sipërfaqeve të gjelbra dhe rezervuarëve për mbajtjen e ujit, mund të krijohen sisteme që ndihmojnë në kontrollin e përmbytjeve dhe rritjen e përthithjes së ujit nga toka.
- Përmirësimin e cilësisë së ujërave nëntokësore: Këto sisteme ndihmojnë në mbajtjen dhe filtrimin natyror të ujit, duke zvogëluar ndotjen.
- Reduktimin e kostove të furnizimit me ujë në sektorët



industrial dhe bujqësor: Përdorimi i këtij burimi të rinovueshëm zvogëlon nevojën për burime ujore të pijshme.

- Përgatitjen për pasojat e ndryshimeve klimatike: Në kontekstin e reshjeve gjithnjë e më të paparashikueshme, ripërdorimi i ujit të shiut është një strategji e zgjuar adaptimi.

Sfidat kryesore për implementimin e këtyre praktikave në Kosovë përfshijnë mungesën e infrastrukturës së duhur dhe politikave stimuluese. Duke marrë shembull nga vendet e Bashkimit Evropian, Kosova mund të zhvillojë politika lehtësuese si:

- Subvencione dhe grante për instalimin e sistemeve të mbledhjes së ujit të shiut në ndërtesa private dhe publike.
- Ulje të tarifave për ujin për ata që implementojnë sisteme të tilla.
- Ulje tatimore për kompanitë që zbatojnë zgjidhje të gjelbra për menaxhimin e ujërave atmosferike.
- Krijimi i një kornize rregullatore që mbështet këto teknologji dhe inkurajon inovacionin në fushën e menaxhimit të ujërave.



Ne jemi të përkushtuar për zbatimin e projekteve gjithëpërfshirëse të ujësjellësit, trajtimit të ujërave të zeza dhe menaxhimit të ujërave të shiut. Këto projekte janë thelbësore për të siguruar furnizim të qëndrueshëm me ujë të pijshëm, për të ulur

ndotjen e burimeve ujore dhe për të përmirësuar infrastrukturën e përgjithshme të ujit në Kosovë.

Ripërdorimi i ujërave të shiut, pas procesit të trajtimit, do të ndihmojë jo vetëm në ruajtjen e burimeve natyrore dhe parandalimin e përmbytjeve, por edhe në krijimin e një sistemi më të qëndrueshëm dhe rezistent ndaj sfidave mjedisore. Ne jemi të angazhuar që këto projekte të përmbushen brenda afateve të përcaktuara, duke respektuar standardet më të larta të cilësisë dhe duke siguruar përfitime afatgjata për qytetarët dhe mjedisin e Kosovës.

Për të arritur këto objektiva, ne do të punojmë ngushtë me ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë, do të kërkojmë financime nga burime të ndryshme, dhe do të promovojmë ndërgjegjësimin publik për rëndësinë e menaxhimit të qëndrueshëm të ujërave. Gjithashtu, do të inkurajojmë pjesëmarrjen aktive të komuniteteve lokale në këto projekte, duke siguruar që zgjidhjet e propozuara të jenë të përshtatshme për nevojat specifike të çdo rajoni të Kosovës.

# ***SOLIDARITETI DHE PËRKRAHJA SOCIALE***



# Shëndetësia

**Konteksti, Sfidat, Mundësitë** – Shëndetësia është një nga sektorët më të rëndësishëm për jetën dhe mirëqenien e qytetarëve. Programi ynë synon të sigurojë një sistem shëndetësor cilësor dhe të qasshëm për të gjithë qytetarët e Kosovës



## **Masat dhe Veprimet:**

- Krijimi i Strategjisë për reformë të thellë shëndetësore në të tre nivelet: primar, sekondar dhe terciar.

- Mjeku i familjes për çdo familje: koalicioni përcaktohet që çdo familje në Kosovë ta ketë mjekun e vet familjar.
- Sigurimi i buxhetit dyvjeçar për fondin e sigurimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët.
- Zbatimi i një plani të detajuar për revitalizimin e plotë të QKUK-së, duke u nisur nga infrastruktura deri te kuadri profesional.
- Autonomia e plotë për spitalet rajonale, duke i bërë ato kompetente për shërbime të profilizuara shëndetësore.
- Stomatologjia të kalojë në sektorin primar.
- Krijimi i sistemit informativ shëndetësor (SISH).
- Programet e avancuara për personelin shëndetësor.
- Zgjerimi i listës esenciale të barnave deri në funksionalizimin e sigurimeve shëndetësore.
- Partnerët strategjikë për trajnime specifike subspecialistike.
- Vija e veçantë buxhetore për Spitalet Rajonale dhe Klinika (QKUK).
- Rikthimi i përgjegjësisë në nivel të menaxherit (drejtorit) edhe në kuadër të kujdesit primar shëndetësor (KPSH).
- Laboratori në kuadër të Klinikës së Biokimisë në QKUK: Ndërtimi i një laboratorit për analiza specifike për të arritur diagnostikimin e saktë dhe të shpejtë për sëmundje specifike.
- Konkursi për specializantë: Konkurs i hapur, bazuar në numrin e të diplomuarve dhe Strategjinë Shëndetësore.

# Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit

**Konteksti, Sfidat, Mundësitë** – Zhvillimi ekonomik dhe social i Kosovës, i përshtatur me tregun konkurrues botëror, kalon detyrimisht nëpërmjet rritjes së produktivitetit ekonomik në administratë, në biznes, në prodhimin industrial dhe në tregjet financiare. Për të mundur edhe në Kosovë rritjen ekonomike të dhjetëvjeçarit të ardhshëm, falë inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), nevojitet të përforcohen kushtet ligjore, ekonomike dhe të aftësohen kapacitete të rëndësishme njerëzore.



## Masat dhe Veprimet:

- Shtimi dhe promovimi i shërbimeve dixhitale, e-shërbimeve, për qytetarët dhe biznesin. Prioritet do të jetë rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratë.
- Rritja e shërbimeve në arsim për të kapërcyer hendekun dixhital dhe për të aftësuar rininë. Politikat do të jenë të orientuara drejt përmirësimit dhe zgjerimit të kapaciteteve njerëzore në mënyrë që të rritet si numri i përdoruesve, ashtu edhe numri i ofruesve vendas të e-shërbimeve. Në këtë mënyrë do të nxitet krijimi i vendeve të punës në këtë fushë për tregun e Kosovës, rajonal e më gjerë.

- Konsolidimi i infrastrukturës dixhitale në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, duke respektuar me rigorozitet parimet evropiane të konkurrencës së lirë e të ndershme.
- Ndërtimi i një Kampusi - Shkollë e Mesme dhe Universitet madhështor për IT. Ofrimi i shërbimeve të IT është shpëtim për rininë dhe veprimtaria e shekullit 21. Themelimi i një Qendre më të madhe në Ballkan, ku të rinjtë shfrytëzojnë zyra dhe infrastrukturë pa pagesë për ofrimin e shërbimeve të IT.



## Arsimi

**Konteksti, Sfidat, Mundësitë** – Rezultatet e dobëta në arsimin fillor dhe të mesëm, programet universitare në shpërputhje me nevojat e tregut të punës, pagat e ulëta për punëtorët e arsimit, emigrimi e zvogëlimi i madh i numrit të nxënësve dhe studentëve, problemet me tekstet shkollore, e shtrojnë nevojën urgjente të reformës në arsimin e të gjitha niveleve në Kosovë.

## Masat dhe Veprimet:

- Rritja e buxhetit për arsim në 6% të GDP-së dhe përmirësimi i infrastrukturës arsimore:
  - o Rritja e pagës për punëtorët e arsimit në të gjitha nivelet për 50%.
  - o Përmirësimi i infrastrukturës fizike duke u përshtatur me kriteret bashkëkohore.
  - o Rritja e sigurisë në shkolla.
- Reforma në organizimin e shkollave dhe arsimit të lartë:
  - o Rrjetëzimi i shkollave duke i bashkuar paralelet e ndara dhe shkollat fillore me më pak se 50 nxënës. Kjo përfshin organizimin e mësimit territorial, punën me klube, aktivitetet shtesë në lëndë prioritare, si dhe aktivitetet jashtëkurrikulare. Gjithashtu, siguron sistemimin e të gjithë mësimdhënësve me normë të plotë pune.
  - o Trajtimi i barabartë i universiteteve publike dhe private përmes monitorimit të performancës.
  - o Profilizimi i institucioneve të arsimit të lartë dhe pavarësimi financiar i tyre.
  - o Certifikimi dhe akreditimi i instituteve shkencore, duke krijuar mundësi për gjenerimin e të hyrave vetanake.
- Përmirësimi i cilësisë së arsimit:
  - o Tekste falas për arsimin parauniversitar, duke siguruar tekstet shkollore bazike dhe disa tekste në format digjital.



- o Arsimi gjithëpërfshirës, duke garantuar kuadrin profesional për fëmijët me nevoja të veçanta.
  - o Trajnime të vazhdueshme falas për të gjithë mësimitdhënësit, me fokus në fushat STEM, gjuhë shqipe, të menduarit kritik dhe kreativ në mësimitdhënie.
  - o Mbështetja e programeve për arsimin profesional sipas nevojave të tregut.
  - o Rishikimi i politikave për arsim profesional me fokus në arsimin dual, duke bashkëpunuar dhe stimuluar bizneset për bashkëpunim me shkollat profesionale.
- Ndërtimi i politikës së re për karrierën e drejtorëve të shkollave, zëvendësrejtoreve, koordinatorëve të cilësisë dhe udhëheqësve të aktivitetit profesional. MASHT, me mbështetjen e Institutit Pedagogjik dhe Fakultetit të Edukimit, do të zhvillojë dhe zbatojë programe profesionale dhe akademike për këto pozita, duke mundësuar zhvillimin në karrierë përmes gradimit dhe avancimit, shoqëruar me ngritje të pagës për secilin nivel.
  - Fuqizimi i strukturave arsimore në nivel lokal:
    - o Mbështetje konkrete për të fuqizuar DKA-të me staf profesional të përhershëm, duke formuar ekipe profesionale komunale që do të shërbejnë si mekanizëm mbështetës për shkollat dhe mësimitdhënësit.
    - o Ngritja e kapaciteteve komunale për rritjen e përfshirjes në edukimin në fëmijërinë e hershme (EFH), duke rritur numrin e institucioneve, adaptuar hapësirat shkollore dhe siguruar materiale edukative për grup-moshat 3-5 vjeç.
  - Politika dhe bashkëpunim:

- o Rregullimi me ligj i arsimit plotësues në diasporë.
- o Negocimi i kontratës së re kolektive me sindikatat e arsimit dhe palët e tjera të interesit.

## Rinia

**Konteksti, sfidat dhe mundësitë** - Shkollimi adekuat, mundësia për rekreacion dhe sport, shërbimet shëndetësore adekuate, dhe krijimi i vendeve të punës, janë zingjiri që nuk guxon të shkëputet. Rinia jonë nuk do ta kalojë kohën duke u përgatitur për të ardhmen që nuk e ka të qartë. Shumica e dukurive negative buron nga mungesa e shkollimit adekuat. Duhet të krijohet agjenda nacionale për rini të edukuar dhe të shëndoshë. Sistemi i edukimit duhet të forcohet, madje edhe rrënjësisht të reformohet. Shtetit i nevojiten kadro të mirëfillta, që duhet të burojnë nga sistemi publik i edukimit. Shkollat private janë të mirëseardhura, por edhe ato duhet të monitorohen. Por, zhvillimi adekuat i kadrove duhet të burojë nga sistemi publik, ku shkollat e mesme dhe fakultetet publike, duhet të paraqesin prestigj dhe krenari për nxënësit e studentët. Shteti duhet të krijojë plane strategjike për zhvillimin e rinisë, të krijojë mundësi jo vetëm për shkollim teorik, por edhe atë praktik. Sot kemi me qindra mijëra ekonomistë e juristë të diplomuar, të cilët as që kemi mundësi, as resurse për t'i punësuar. E në anën tjetër nuk kemi punëtorë profesionistë të zanatit, që do të mund ta zhvillonin ekonominë e vogël dhe të mesme. Pra, shteti është ai që u jep drejtim dhe monitorim këtyre zhvillimeve. Aleanca do të krijojë qartësi për të ardhmen e secilit, aq më tepër do të synojë që rininë tonë ta bëjë pjesëmarrëse në ndërtimin e së ardhmes së vet dhe të shtetit.

**Masat dhe veprimet** - Aleanca synon që të sigurojë e realizojë:

- o Edukim joformal të garantuar për çdo të ri në nevojë për përgatitje në tregun e punës;
- o Identifikimin e talentëve të veçantë dhe trajtimi institucional i karrierës së tyre;
- o Fond për financim të punësimit të parë të të rinjve;
- o Harmonizimin e plotë të politikave arsimore, shëndetësore, kulturore, të punësimit dhe të zhvillimit në relacion me gjeneratat e reja.

# *FAMILJA*



**Konteksti, Sfidat, Mundësitë** - Familja është qeliza bazë e shoqërisë, struktura organizative më e vjetër, e formësuar dhe e ndërtuar me raporte unike midis anëtarëve. Familjen e konsideron të shenjtë edhe sistemi ynë i vlerave; madje kombi ynë, në përgjithësi gjatë historisë, e ka pasur familjen follenë kryesore të idealit kombëtar. Familja shqiptare gjatë gjithë kësaj kohe e ka ruajtur qenësinë kombëtare, dashurinë ndaj atdheut, besimin në Zotin e Madhërishëm, kujtesën historike, respektin ndërkulturor, bashkëjetesën fetare, besën, bujarinë dhe motivin për t'u organizuar për liri kundër regjimit dhe pushtimit shekullor serb.

Ndryshimet e mëdha globale, që kanë prekur pothuajse çdo fushë të shoqërisë si proces i natyrshëm social dhe evolutiv, kanë ndikuar edhe në familje. Këto ndryshime kanë prekur formën e organizimit të familjes, ku nga familja e madhe çdo ditë e më shumë po shkojmë drejt familjes bërthamë. Ato kanë ndikuar në rendin familjar dhe në raportet midis anëtarëve të familjes. Madje kanë ndikuar edhe në gjykimin, perceptimin dhe vlerësimin e rolit, përbërjes dhe funksioneve të familjes. Imun ndaj këtyre rrjedhave dhe ndryshimeve globale që ka pësuar familja, nuk është as vendi ynë.

Familjen e cenojnë një tërësi sfidash dhe rreziqesh të natyrave të ndryshme. Ndikimi i madh dhe i sforcuar i ideologjive, nga më të ndryshmet në mendimin politik, vazhdon të manifestohet në diskursin publik si dhe në hartimin e legjislacionit që prek familjen. Kalimi i shoqërisë nga përgjegjësia kolektive në të drejtën e sforcuar individuale, përvetësimi i papërzgjedhur i vlerave, emigracioni, gjendja ekonomike, sistemi shëndetësor dhe mungesa e edukimit dhe arsimit përmbajtësor në shkolla kanë ndikuar që të preken dhe të cenohen funksionet bazike të familjes.

Mendimi juridik dhe politik konservator tradicionalisht i ka njohur katër funksione bazike të familjes: funksioni i riprodhimit njerëzor, funksioni ekonomik, funksioni i rritjes dhe edukimit të fëmijëve, funksioni shoqëruar i familjes dhe funksioni mbrojtës i

familjes. Prandaj, duhet ndërtuar politika që mbrojnë dhe ruajnë këto funksione bazë të familjes.

### **Veprimet politike:**

Institucionet qendrore dhe vendore, mediat, intelektualët, partitë politike dhe sistemi arsimor duhet ta kenë të qartë se në procesin e shtetformimit, krahas të drejtave, duhet të zhvillohet edhe përgjegjësia për të ruajtur vlerat. Këto janë vlera natyrore që ndërlidhen me të drejtat e patjetërsueshme. Të gjithë së bashku duhet të përpiqemi të ndërtojmë një qasje proaktive ndaj vlerave të cilat burojnë nga besimi në Zot, tradita e mirë kombëtare dhe natyrshmëria njerëzore. Vlera që kultivojnë të drejta dhe përgjegjësi për ta formuar dhe ruajtur familjen e shëndoshë.

Në këtë kontekst, kauza për familjen do të manifestohet në mirëqenien e saj. Në qendër të këtij angazhimi është themelimi i Ministrisë.

Ministria për Familje do të kishte në përgjegjësi dhe kompetencë hartimin e politikave, legjisllacionit dhe planeve financiare për mbështetjen e fuqishme të familjes. Formimi i Ministrisë së Familjes është praktikë e vendeve që synojnë ta ruajnë familjen. Si model dhe studim më i thelluar rreth kësaj mund të merret shteti gjerman, ku është funksionale kjo ministri. Kompetencat e kësaj ministrie konsistojnë në mendimin politik që ka për qëllim krijimin e politikave pro familjes, hartimin dhe miratimin e legjisllacionit që synon kujdesin ndaj familjes, si dhe hartimin dhe nxjerrjen e strategjive për kategori të ndjeshme brenda familjes.

Ministria për Familje do të jetë përgjegjëse për një gamë të gjerë detyrash dhe fushash politike që fokusohen në mbështetjen e familjeve, mbrojtjen e gruas, fëmijëve dhe të rinjve, ndihmën për të moshuarit, si dhe mbështetjen për personat me nevoja të veçanta.



Ndër kompetencat kryesore të Ministrisë për Familje janë:

1. **Politikat për Familje:** Sigurimi i mbështetjes financiare për familjet (p.sh., ndihma për fëmijë, personat me nevoja të veçanta, prindër). Zgjerimi i shërbimeve të kujdesit për fëmijë, përfshirë edhe institucioneve arsimore (p.sh., çerdhe, shkolla me orar ditor të plotë ditor, programe të avancuara). Mbështetja për prindërit e vetëm dhe promovimi i modeleve të punës së përshtatshme për ta (p.sh., punë me kohë të pjesshme, punë nga shtëpia).

2. **Politika për të Moshuarit:** Promovimi i pjesëmarrjes së të moshuarve në shoqëri. Sigurimi i një procesi të denjë plakjeje p.sh., lufta kundër varfërisë në pleqëri, ofrimi i mbështetjes për kujdes. Nxitja e programeve për përfshirjen aktive të moshuarve, si puna vullnetare. Krijimi i mundësive për vazhdimin e dhënies së kontributit të moshuarve edhe pas moshës së pensionimit.

3. **Politika për Gratë:** Promovimi i barazisë dhe drejtësisë gjinore

midis grave dhe burrave. Mbështetja për ekuilibrin e jetës familjare dhe karrierës. Përmirësimi i mundësive profesionale për gratë.

**4. Politika për Rininë:** Nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve në programe studimore, shkencore e hulumtuese. Nxitja e të rinjve për punë vullnetare dhe për pjesëmarrje në proceset politike. Mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve nga rreziqet. Mbështetja e organizatave rinore dhe punës me të rinjtë. Lehtësimi i integritit të rinjve në tregun e punës dhe shoqëri.

**5. Angazhimi Vullnetar dhe Qytetar:** Nxitja e angazhimit vullnetar dhe qytetar në sektorë të ndryshëm të shoqërisë. Angazhimi për të ulur pabarazitë sociale, për të promovuar mundësi të barabarta dhe për të forcuar kohezionin social.

Institucionet qendrore si Kuvendi dhe Qeveria, të jenë të kujdesshme në hartimin e legjislacionit që prek familjen. Është e pa kuptimtë tendenca e ligjësimit të martesave një gjinore, sterilizimi apo fekondimi artificial për femrat e pamartuara mbi 18 vjet, largimi i konceptit baba dhe nënë për ta zëvendësuar me prindi 1 dhe prindi 2 apo e drejta e çifteve njëgjinore për të adoptuar fëmijë. Është zotim i yni që në hartimin e legjislacionit të kemi kujdesin dhe vëmendjen kryesore ndaj familjes. Nismat ligjore dhe politike do të jenë në pajtim me interesin e familjes dhe të ardhmes së saj.

Familja është kauzë e rëndësishme madje duke ju referuar historisë sonë, të tashmes dhe të ardhmes, jemi të bindur se familja është themeli më i fuqishëm i Kombit tonë dhe garanti i qëndrueshmërisë sonë kombëtare.

## **Pakoja për Mirëqenien e Familjes**



Në funksion të fuqizimit të familjes, në 100-ditëshin e parë, Ministria për Familje do të hartojë projektin e quajtur “Pakoja për Mirëqenien e Familjes” e cila do të përfshijë të nevojat për mirëqenien e familjes. Kjo pako do të aprovohet nga Qeveria e Kosovës për shkak të përfshirjes së disa ministrive në realizimin e saj.



Pakoja për Mirëqenien e Familjes përfshinë:

- Shtesat për fëmijë dhe lehonat.
- Përkujdesi për personat e shtyrë në moshë.
- Përkujdesi për personat me nevoja të veçanta.
- Sigurimi i banimit për çiftet e sapo martuara.
- Sigurimi social për mbështetje financiare në vlerën e një page minimale për personat që mbesin pa punës deri në gjashtë muaj.
- Sigurimi shëndetësor si garanti më i mirë i mundësisë për marrjen e shërbimeve cilësore shëndetësor.
- Shtesa për fëmijët deri në moshën 6 vjeçare në vlerën mujore prej 120 euro.

- Shtesa për fëmijët deri në moshën 16 vjeçare në vlerën mujore prej 150 euro.
- Mbështetja në vlerën e pagës minimale për gratë e papunësuara të cilat kanë 3 fëmijë e më shumë, deri në 10 vite.
- Subvencionimi në vlerën prej 1500 euro për lindjen e parë, 2500 për lindjen e dytë dhe 3500 për lindjen e tretë.
- Subvencionimi në vlerën e pagës minimale për një vit për lindjen e parë dhe të dytë për gratë e papunësuara. Ndërsa në vlerën e 80% të pagës bazë deri në 16 muaj për të punësuarat.
- Zgjatja e pushimit të lehonisë deri në 16 muaj për nënën dhe tre muaj për babain.
- Zgjatja e pushimit mjekësor për sëmundje të rënda për të punësuar deri në 12 muaj me pagë të plotë.
- Subvencionimi i themelimit të bizneseve të profesioneve të lira, sikur se avokatët, kontabilistët, arkitektët e të tjerë, për mbulimin e qirave mujore dhe rregullimit elementar të zyrave deri në 5 muaj.
- Mbështetja financiare dhe përkujdesi shtëpiak përmes ndërmarrjeve sociale për personat me nevoja të veçanta dhe të moshuar, e organizuar nga niveli qendro dhe local.
- Miratimi me urgjencë i Ligjit për vlerësimin, njohjen e statusit, përfitimet dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuar.
- Luftimi dhe parandalimi i dukurive negative në familje si varësia e anëtarëve të familjes nga alkooli, droga, lojërat e fatit apo edhe varësia ndaj rrjeteve sociale përmes një qendre konsultimi, edukimi e vetëdijesimi e cila do të themelohet pranë Ministrisë për Familje.
- Hartimi dhe angazhimi multidisiplinar për një strategji

gjithëpërfshirëse kundër dhunës në familje.

- Ndërtimi i banesave për çiftet e reja përmes programit të Qeverisë, partneritetit publiko-privat dhe subvencionimit të kredive.
- Hartimi i Strategjisë, tre deri pesëvjeçare, për kontrollin dhe parandalimin e emigrimit, duke përfshirë detyrimet e institucioneve shtetërore, sistemin vleror, subvencionimin e ideve dhe projekteve ekonomike, vënien në kontakt të ngushtë midis institucioneve dhe mërgatës, si dhe planifikimin e regjistrimit të pasurisë pronësore dhe intelektuale të mërgatës.

Krijimi i mirëqenies për familjen është komplementar dhe gjithëpërfshirës, prandaj kërkon angazhimin e shumë ministrive dhe agjencive qeveritare.

[www.aak-ks.org](http://www.aak-ks.org)